



AUTORITETI I
KONKURRENCËS

RAPORTI VJETOR 2024

PRIORITETET PËR VITIN 2025

LISTË SHKURTIMESH.....	3
PJESA E PARË	4
1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë	4
PJESA E DYTË.....	14
ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURENCËS.....	14
2.1 Tregjet e monitoruara.....	14
2.2 Marrëveshjet e ndaluara.....	21
2.3 Abuzimi me pozitën dominuese.....	27
2.4 Përfshirje nga ndalimi i marrëveshjeve	27
2.5 Kontrolli i perqendrimeve.....	35
2.5.1 Transaksione në tregun e brendshëm	41
PJESA E TRETË.....	53
AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE.....	58
3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	58
3.2 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë	58
3.3 Çështje të gjykuara në Gjykatën e Lartë	60
3.4 Ekzekutimi i vendimeve të komisionit të konkurrencës	60
PJESA E KATËRT.....	62
4.1 Vlerësimi i akteve dhe projektakteve normative	62
4.2 Advokacia e Konkurrencës	66
PJESA E PESTË.....	67
INTEGRIMI EVROPIAN dhe BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	67
5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian	67
5.2 Memorandume Bashkëpunimi	68
5.3 Bashkëpunimi Ndërkombëtar	68
PJESA E GJASHTË	72
ORGANIZIMI I AUTORITETIT	72
6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës	72
6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2024	72
6.3 Të ardhurat e realizuara	73
6.4 Trajnimet dhe rekrutimet	73
PJESA E SHTATË	75
PRIORITETET E AK PËR VITIN 2025	75
7.1 Prioritetet e AK për vitin 2025.....	75
7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE	75

LISTË SHKURTIMESH

AK	Autoriteti i Konkurrencës
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
BE	Bashkimi Europian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FNT	Fuqi të ndjeshme në treg
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
FSHF	Federata Shqiptare e Futbollit
GLN	Gazi i Lëngshëm i Naftës
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
ICN	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit në BE
IDP	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informimit publik
KE	Komisioni Europian
KK	Komisioni i Konkurrencës
Ligji nr. 9121/2003	Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-GVH/RCC	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik për Evropën Juglindore
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Europian
RSH	Republika e Shqipërisë
SFJB	Shoqëri Financiare Jobankare
TIA	Tirana International Airport
UK	Ujësjellës Kanalizime
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
VKK	Vendim i Komisionit të Konkurrencës

PJESA E PARË

1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna me Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023”, protokolluar me shkresën nr. 511 prot., i AK, datë 25.07.2024, statusi i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë vijon:

1. Autoriteti i Konkurrencës duhet të vijojë të përforcojë zbatimin e rregullave të konkurrencës, me qëllim që të ndihmojë në sigurimin e një tregu më të drejtë dhe konkurrues në Shqipëri, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe duke nxitur një mjedis të shëndetshëm të biznesit, me qëllim:

- a) monitorimin e ndërmarrjeve që operojnë në industrinë e turizmit;**
- b) sigurimin e një konkurrence efektive në tregun e shërbimeve bankare digjitale nëpërmjet monitorimit të tarifave dhe komisioneve të shërbimeve bankare;**
- c) sigurimin e një konkurrence efektive duke vijuar monitorimin e tregut të sigurimeve;**
- ç) sigurimin e një tregu të drejtë dhe konkurrues për produkte të shportës, që nuk kanë qenë objekt hetimi në 5 vjetët e fundit, si dhe**
- d) të vijojë me procedurat e monitorimit dhe hetimit në tregun e shërbimit spitalor privat dhe tregun e çimentos në përputhje me rezolutën e vitit 2022.**

AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.

a) monitorimin e ndërmarrjeve që operojnë në industrinë e turizmit;

Në kuadër të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024”, nëpërmjet të cilës i është kërkuar Autoritetit “Monitorimi i ndërmarrjeve që operojnë në industrinë e turizmit”, AK në zbatim të nenit 28, pika “a” të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (ligji nr. 9121/2003), zhvilloi procedurën e monitorimit të ndërmarrjeve që operojnë në këtë industri.

Në kuadër të procedurës së monitorimit ju kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Gjithashtu u vlerësua i rëndësishëm dhe identifikimi i subjekteve (fizike dhe juridike), të cilët gjatë vitit 2024 kishin nënshkruar Kontratën për Përdorimin e Hapësirës së Plazhit/Kontratë Qiraje të ndodhur nën juridiksionin e: Bashkisë së Durrësit, Kavajës, Vlorës, Himarës, Sarandës dhe Shkodrës. Informacion për sa më sipër iu kërkua dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Nga informacioni i dërguar nga DPT dhe AKB, Sekretariati i AK arriti të identifikonte strukturat akomoduese të cilat kishin xhiron më të lartë dhe sipërfaqen më të madhë të zënë buzë detit për vitin 2023 në Bashkitë e Durrësit, Tiranës, Kavajës, Vlorës, Himarës, Sarandës dhe Shkodrës. Me identifikimin e tyre, ishte e rëndësishme të identifikoheshin dhe termat e ekskluzivitetit që këto struktura akomoduese kishin me agjensi shqiptare ose të huaja, për të parë nëse ka shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Si përfundim, nuk u evidentuan prova apo nuk u ngrihen dyshime të arsyeshme se, për ndërmarrjet që operojnë në industrinë e turizmit, të këtë problematika apo elementë të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të ligjit nr. 9121/2003. Tregu i shërbimeve të turizmit konsiderohet i hapur dhe konkurrues me një numër të madh operatorësh dhe ku rritja e çmimeve ndodh si pasojë e kërkesë/ofertës.

b) sigurimin e një konkurrence efektive në tregun e shërbimeve bankare digjitale nëpërmjet monitorimit të tarifave dhe komisioneve të shërbimeve bankare;

AK, bazuar në nenin 28, pika (a) të ligjit nr. 9121/2003, realizoi monitorimin e tregut të shërbimeve bankare. AK i është drejtuar bankave të nivelit të dytë duke kërkuar informacion mbi tarifën dhe komisionet e shërbimeve bankare të vendosura mbi tërheqjen e parave në bankomatet e bankave të cilat operojnë në Bashkinë Sarandë, si dhe ka realizuar takime konsultative me disa nga bankat dhe me Shoqatën e Bankave, sipas problematikave të shfaqura gjatë përpunimit të informacionit të administruar.

Nga monitorimi u konkludua se, në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003, asnjë nga bankat nuk ka pozitë dominuese në këtë treg. Klientët kanë mundësi të zgjedhin lirisht në cilin bankomat të kryejnë tërheqjet e tyre, duke mos u kufizuar nga banka në të cilën kanë llogarinë bankare. Asnjë bankë nuk aplikon komision për tërheqjet në rrjetin e tyre të bankomateve, për kartat e lëshuara nga bankat e tjera vendase.

Tarifat dhe komisionet e aplikuara nga bankat për tërheqjet me karta ndërkombëtare, si dhe për tërheqjet e klientëve të tyre në bankomatet e bankave të tjera ndryshojnë midis bankave, por diferencat nuk janë domethënëse. Bankat që përdorin rrjete të nënkontraktuara zakonisht aplikojnë tarifa më të larta për këtë shërbim.

E njëjta gjë vlen dhe për aplikimin e mark-up, si një përqindje shtesë për ofrimin e Shërbimit të Këmbimit Dinamik të Valutës (DCC), i cili është një shërbim opsional që u ofrohet klientëve me karta të huaja, duke i lejuar tërheqjen e parave në monedhën origjinale të kartës me një kurs këmbimi të aplikuar nga banka.

Si përfundim, nuk u ngritën dyshime të arsyeshme se në tregun e ofrimit të shërbimeve bankare në bankomatet në Bashkinë Sarandë të këtë problematika apo elementë të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003.

c) sigurimin e një konkurrence efektive duke vijuar monitorimin e tregut të sigurimeve;

Në zbatim të vendimeve të KK nr. 751, datë 26.11.2020 “Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, si dhe të VKK nr. 1101, datë 29.08.2024 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, AK është duke vijuar më monitorimin e tregut të produktit të karonit jeshil dhe TPL.

ç) sigurimin e një tregu të drejtë dhe konkurrues për produkte të shportës, që nuk kanë qenë objekt hetimi në 5 vjetët e fundit,

Në lidhje me produktet e shportës, AK gjate vitit 2024 ka realizuar 4 monitorime dhe 2 hetime në tregjet e mëposhtme:

- Tregu i shitjes së bukës

Nisur nga informacione mediatike në lidhje me njoftimin e furrave të bukës për rritjen e çmimit të bukës, AK bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121/2003, ngriti grupin e punës përgjegjës për monitorimin e çmimit të prodhimit dhe tregtimit të bukës pas hyrjes në fuqi të vendimit të ERE nr. 72, datë 15.04.2024, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve “furra buke dhe/ose prodhim mielli”.

Në zbatim të këtij urdhëri u kryen monitorime në terren, në qytetin e Tiranës pranë subjekteve “Furra buke”, nga ku rezultoi se nga data 1 nëntor 2024 nuk ka asnjë rritje të çmimit të energjisë elektrike për furrat e bukës, si dhe furrat e bukës nuk kanë ndryshuar apo rritur çmimin e bukës, duke mos u ndodhur para një sjelljeje të mundshme antikonkurruese nga ana e këtyre subjekteve, në kuptim të ligjit nr. 9121/2003.

- Tregu i tregtimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë

AK në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, vendosi të realizojë monitorimin e tregut të tregtimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë dhe analizimin e kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Për mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të nevojshme, janë kërkuar të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në lidhje me sasinë e importuar sipas kategorisë së kafesë për subjektet importuese që prej datës 1 janar 2023 e në vazhdim, si dhe nga Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në lidhje me subjektet tregtare, të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e përpunimit dhe tregtimit të kafesë.

Duke qënë se nga analizimi të dhënave të administruara u vu re një trend rritës i çmimeve të kafesë së importuar, si dhe nga njoftimet në median e shkruar lidhur me një rritje të pritshme të çmimit të kafesë në bare dhe restorant, ky treg do të vijojë të mbahet në monitorim nga AK.

- Tregu i tregtimit të produkteve të shportës ushqimore

AK, gjatë muajit dhjetor 2024, realizoi monitorim të menjëhershëm në terren për çmimet e produkteve të shportës ushqimore, të ndikuar nga festat e fundvitit, me qëllim evidentimin, parandalimin dhe penalizimin e atyre ndërmarrjeve tregtare të cilat abuzojnë me çmimet në shkelje të ligjit nr. 9121/2003. Ky monitorim është në proces.

- Tregu i prodhimit, shitjes së nënprodukteve të qumështit

KK, me vendimin nr. 1052, datë 25.01.2024, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)”, duke marrë shkas edhe nga disa njoftime mediatike të ditëve të fundit, për protesta të zhvilluara nga blegtorët, sidomos në zonat e Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës, Delvinës, Tepelenës, Përmetit, Fierit etj, për çmimin e blerjes së qumështit nga ana e grumbulluesve dhe fabrikave përpunuese të qumështit, vendosi zgjatjen e periudhës kohore përcaktuar në pikën “II”, të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)”, me 6 (gjashtë) muaj duke përfshirë periudhën 1 janar 2024 deri në 30 qershor 2024.

Pas procedurave hetimore KK, me vendimin nr. 1131 datë 7.11.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit (djathë dhe gjalpë) ” në vijim të mbylljes së hetimit, vendosi:

- I. T’i rekomandojë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit: Të përforcojë rolin e tij për zbatimin me rigorozitet të kontrolleve përsa i përket cilësisë dhe parametrave mikrobiologjikë të qumështit si lëndë e parë.
- II. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave: Të ndërmarrë nisma për një “Strategji të integruar në luftën kundër informalitetit” si insitucioni kompetent dhe përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e informalitetit në treg.
- III. T’i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që: (i) Të ndërmarrë nismën për hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 9441, datë 11.11.2005, me qëllim rregullimin e tyre dhe rritjen e konkurrencës në treg, bazuar në problematikat e konstatuara në tregun e prodhimit dhe tregtimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij; (ii) Të ndërmarrë nismën për krijimin e një baze të dhënash për monitorimin e çmimeve me pakicë të produkteve të shportës (nënprodukteve të qumështit), me qëllim rritjen e konkurrencën përmes transparencës dhe krahasueshmërisë më të mirë të këtyre çmimeve online.

- *Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve*

AK në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve, për analizimin e kushteve të këtij tregu. Pas monitorimit të tregut u konstatua se referuar strukturës së tregut, integritimit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, mund të jemi para një sjelljeje antikonkurrense si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr 9121/2003”.

Per këto arsye, KK me vendimin nr. 1085, datë 14.06.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”, vendosi hapjen e hetimit paraprak për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

Pas analizimit të strukturës së tregut, integritimit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, u vlerësua se ky treg mund të ketë sjellje antikonkurruese, si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 dhe KK, me vendimin nr. 1114, datë 04.10.2024 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, berat, Fier dhe Korçë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar.

d) të vijojë me procedurat e monitorimit dhe hetimit në tregun e shërbimit spitalor privat dhe tregun e çimentos në përputhje me rezolutën e vitit 2022.

AK, në zbatim të rekomandimit të dhënë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022” dhe Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023” nga Kuvendi i Shqipërisë, me Urdhrin nr. 46, datë 24.10.2023 “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e tregut të shërbimit spitalor privat”, ka filluar procedurën e monitorimit të këtij tregu.

Në zbatim të nenit 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, AK i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të kërkuar informacion në lidhje me listën e spitaleve jopublike si dhe spitaleve jopublike për të marrë informacion mbi tarifatat për disa shërbime dhe paketat që këto spitale ofrojnë, metodologjinë e llogaritjes së kostos për këto shërbime. Për të realizura një krahasim rajonal (benchmark), AK, nëpërmjet mekanizmit të RFI-së (Kërkesë Për Informacion) në rrjetin OECD-GVH/RCC, ka kërkuar informacion në lidhje me disa nga shërbimet mjekësore që ofrohen në spitalet private, për ndonjë procedurë hetimore/monitorimi të iniciuar prej tyre, çmimet e këtyre shërbimeve, si dhe ndonjë akt ligjor apo ndonjë ndërhyrje të shtetit që rregullon këto tregje dhe çmime. Gjithashtu i është drejtuar me anë të emailit, disa prej spitaleve private të vendeve të rajonit (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Greqi dhe Itali), duke kërkuar informacion mbi tarifatat e ofrimit të disa shërbimeve spitalore. Në vijim AK i është drejtuar spitaleve private mbi shërbimet ekskluzive spitalore si dhe tarifatat përkatëse.

Autoriteti i Konkurrencës është duke vijuar monitorimin e këtij tregu.

- Tregu i prodhimit/ importit dhe shitjes me shumicë të çimentos

KK, me vendimin nr. 895, datë 05.07.2022 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në këtë për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003. Hetimi paraprak përfshin periudhën

kohore 1 janar 2021 deri në 30 qershor 2022. Në përfundim të analizës së realizuar gjatë periudhës hetimore u konstatuan elementë të cilët mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 dhe për këto arsye, KK me vendimin nr. 969, datë 24.03.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë për periudhën kohore nga 1 janari 2019 deri në 31 mars 2023.

KK, me vendimin nr. 1091, datë 01.07.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë dhe gjorbitjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për abuzim me pozitën dominuese” vendosi:

- I. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri.
- II. Gjorbitjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, në shumën 97,700,736 (nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) Lekë. Theksojmë që gjoba e mësipërme është arkëtuar plotësisht dhe kaluar në buxhetin e shtetit.
- III. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA, për një periudhë (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

Tregu është në monitorim.

2. Të hartohet një raportim i detajuar për përmbushjen e rekomandimeve të rezolutave të Kuvendit për të siguruar transparencë më të madhe dhe vlerësim më të saktë të përmbushjes së rekomandimeve.

AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.

AK, raporton në mënyrë të vazhdueshme mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në rezolutën e kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe në mënyrë më të detajuar është bërë pjesë e Raportit Vjetor të AK, në pjesën e parë të raportit “1.1 Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Të sigurohet që procedurat hetimore dhe monitorimet të përfundojnë në kohë të arsyeshme, me qëllim zgjidhjen e problematikave pa humbur aktualiteti, për çështje që kanë një ndikim në mirëqenien e konsumatorit.

AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.

Ligji nr. 9121/2003 ka përcaktuar afate specifike për ndjekjen e procedurave hetimore, të cilat përcaktohen në vendimmarrjen e KK dhe janë të detyrueshme për tu zbatuar nga Sekretariati. Megjithatë, në praktikë, zbatimi i këtyre afateve shpesh ndikohet nga disa faktorë, siç janë volumi i madh i informacionit të ardhur, kërkesa për shtyrjen e afateve për dërgimin e

informacionit nga ndërmarrjet, dërgim i informacionit nga palët në formë jo të kuptueshme apo të pasaktë (që sjell si pasojë kërkesat për informacion të përsëritura nga AK). Këto faktorë ndikojnë në zgjatjen e afateve për përfundimin e procedurave hetimore.

Pavarësisht këtyre vonesave, AK synon që procedurat hetimore dhe monitorimet të përfundojnë në një kohë të arsyeshme, me qëllim që të sigurohet një hetim i plotë dhe i saktë, duke garantuar që zgjidhja e çështjeve të bëhet pa humbur aktualitetin e problematikës.

AK në çdo rast merr të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar vonesat dhe për të siguruar që procedurat hetimore dhe monitorimet të kryhen në përputhje me afatet dhe kërkesat ligjore.

4. Të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional me në fokus Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Komisionin e Prokurimit Publik për të siguruar përmbushjen e rekomandimeve të dhëna dhe për të adresuar çështjet e konkurrencës në mënyrë më efektive. Të reflektohet gjendja e zbatimit të rekomandimeve në Platformën Ndërinstitucionale Online.

AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.

AK, është vazhdimisht i hapur për bashkëpunim ndërinstitucional. Mbështetur në shkresën e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023), nëpërmjet të cilit u depozitua Vendimi nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.Bo - Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023”, KK vendosi për hapjen e procedurave hetimore ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK. Në përfundim të procedurës hetimore, KK me Vendimin nr. 1049, datë 16.01.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK, dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK”, vendosi për mbylljen e hetimit dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjeve nën hetim.

Gjatë vitit 2024 AK nuk ka patur raste të referuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për çështje të konkurrencës.

5. Të krijohet një sistem i menaxhimit të informacionit që të përmirësojë qasjen dhe përdorimin e të dhënave në mënyrë efektive dhe efikase. Të krijohet një sistem për trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe biznesit lidhur me praktikant antikonkurruese dhe për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.

Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës ka qenë prioritet i institucionit që nga viti 2022.

Me shkresën nr. 279 prot., i AK datë 20.04.2022 “Kërkesë për zhvillim procedure” Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ngritja e sistemit të menaxhimit të

informacionit për Autoritetin e Konkurrencës”, në përfundim të së cilës u hartuan Specifikimet Teknike nga personat përgjegjës, si dhe u përllogarit fondi për realizimin e këtij procesi. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 8025 prot., datë 22.12.2022 ka kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës konfirmimin e fondeve për të vijuar me realizimin e procedurës.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka patur të miratuar fond investimesh për informatizimin e sistemit të menaxhimit të informacionit dhe për këtë arsye, me shkresën nr. 32 prot., datë 16.01.2023 “Mbi procedurën me objekt: “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës” dhe shkresën nr. 32/2 prot., datë 21.09.2023 “Kthim përgjigje për procedurën e me objekt: “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës”, ka kërkuar nga AKSHI mbështetje financiare për këtë projekt.

Në përgjigje të kërkesave, AKSHI informon se e ka të pamundur të parashikojë fonde për këtë projekt dhe se tavani buxhetor i vitit 2024 për art. 231 (investime), i caktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është i pamjaftueshëm.

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr.170/9 prot., datë 01.09.2023 “Dërgohen kërkesat buxhetore shtesë dhe PBA 2024-2026, faza 2”, i ka kërkuar Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, që në zbatim të kërkesave të Kuvendit, si dhe në vijim të korrespondencës shkresore me AKSHI-n, të na miratojë nevojën për fonde buxhetore për projektin “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës”, si më poshtë:

- Për vitin 2024 kërkohet një shtesë prej 228,059,184 lekë e cila ndahet në:
 - Vlerën e implementimit të projektit që është në shumën 174,059,784 lekë dhe
 - Vlerën e mirëmbajtjes që është në shumën 53,366,400 lekë;
- Për vitet 2025 dhe 2026 kërkohen përkatësisht 53,366,400 lekë, si fond i nevojshëm për mirëmbajtjen e sistemit.

Gjithashtu me shkresën nr.637 prot., datë 10.11.2023 “Kërkesë për shtesë në buxhetin e viteve 2024, 2025 dhe 2026 për Autoritetin e Konkurrencës”, i është kërkuar Kryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, që në miratimin e buxhetit të vitit 2024, Ministria e Financës dhe Ekonomisë të parashikojë fonde buxhetore, në zërin e investimeve, për Autoritetin e Konkurrencës, për të mbështetur projektin e menaxhimit të informacionit për Autoritetin e Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës, në buxhetin e vitit 2024, nuk ka patur të miratuar fonde në zërin investime për të mbështetur projektin e menaxhimit të informacionit pranë AK.

Gjithashtu AK, në zbatim të këtij rekomandimi; ligjit nr. 33, datë 31.3.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ka publikuar në faqen zyrtare rubrikën “Të dhënat e hapura”, që përmban informacion në lidhje me: Ligjin dhe aktet nënligjore në fushën e konkurrencës; Vendimet e KK; Raportet dhe studimet e tregut; Raportet Vjetore të AK; Të dhënat e

prokurimeve publike; Informacione mbi shërbimet dhe procedurat administrative; Dokumentet e konsultimeve publike; Të dhënat statistikore; Informacion mbi edukimin dhe ndërgjegjësimin dhe Informacion mbi procedurat e përqëndrimeve.

Gjithashtu në faqen zyrtare të AK gjendet dhe rubrika “Dërgo Ankesë”, ku Autoriteti në kohë reale administron ankesat duke përshpejtuar kohën e shqyrtimit të tyre.

6. Të fillojë puna për hartimin e një dokumenti strategjik afatgjatë “Politika e Konkurrencës” për monitimin e tregjeve kryesore dhe të një plani veprimi me indikatorë të qartë e të matshëm.

AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës.

AK me urdhrin nr. 1, datë 28.08.2024 ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e dokumentit strategjik “Politika e Konkurrencës”, i cili pritet të përfundojë gjatë vitit 2027. Pjesë e procedurës do të jetë dhe konsultimi me palët e interesit.

7. Të rritet transparencja dhe llogaridhënia në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës përmes publikimit të raporteve periodike, analizave të detajuara, statistikave të përditësuara në formate miqësore për publikun, njoftimeve të qarta dhe vendimeve të mirargumentuara.

AK ka përmbushur këtë rekomandim të dhënë sipas Rezolutës .

AK, në zbatim të kësaj pike të rezolutës, ka vendosur në faqen zyrtare elektronike të saj një kategori të gjerë informacioni, i përmbledhur si më poshtë:

- Programi i transparencës i përditësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rreth autoritetit;
- Kuadri ligjor rregullator;
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AK;
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat;
- Shërbimet që ofrohen nga AK;
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AK;
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve;
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
- Informacione/dokumente në zbatim të ligjit nr. 9121/2003:
 - Buletinet zyrtare të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës;
 - Publikime të Raporteve Vjetore të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës;
 - Njoftime për shtyp;
 - Newsletter e veprimtarisë së Autoritetit çdo vit dhe të publikuar në faqen web të Autoritetit dhe në rrjetet sociale të tij.

8. Të vijojë përafrimi i kuadrit nënligjor me standardet dhe praktikat e Bashkimit Europian, të ketë një rol proaktiv në advokacinë e konkurrencës dhe vijimin e trajnimit të stafit të ri dhe atij ekzistues.

AK ka përmbushur këtë rekomandime të dhëna sipas Rezolutës.

Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, Komisioni i Konkurrencës, gjatë vitit 2024 ka miratuar aktet si me poshtë:

- 1- Me Vendimin nr. 1093, datë 11.07.2024, ka miratuar Udhëzimin "Mbi zbatimin e Ligjit nr. 9121/2003 "Mbi mbrojtjen e konkurrencës" për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së të vetëpunësuarve", në përputhje me 'Njoftimin e Komisionit Evropian "Udhëzime mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës së Bashkimit Evropian për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar të pavarur" (2022/C 374/02)'.
- 2- Me Vendimin nr. 1108, datë 16.09.2024, ka miratuar Udhëzimin "Për referimin e çështjeve në lidhje me përqendrimet", në përputhje me 'Njoftimin e Komisionit Evropian "Për Referimin e Çështjeve në lidhje me Përqendrimet (2005/C 56/02)'.

AK ka realizuar plotësisht Planin Kombëtar për Integrimin Evropian për vitin 2024.

- Në kuadër të Platformës së Partneritetit është organizuar një takim, me fokus në prezantimin e nismave të reja ligjore dhe akteve të miratuara nga Komisioni i Konkurrencës në kuadër të PKIE 2023-2025.
- Takimi i 15-të i Nën Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrueshmëria përfshirë Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit", e zhvilluar në 30 maj 2024 në Bruksel. AK paraqiti një raport të hollësishëm të aktivitetit të institucionit, lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit dhe nismat e parashikuara në të ardhmen, aktivitetet zbatuese dhe implementimin e ligjit si dhe lidhur me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Përfaqësuesit e BE-së vlerësuan ndërhyrjet në treg nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e KK, rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore e ato rregullatore, si dhe procesin e përafrimit dhe plotësimit të legjislacionit.

AK, në kuadër të promovimit të advokacisë dhe kulturës së konkurrencës, ka organizuar workshope dhe takime me grupet e interesit, botën akademike dhe mediat. Gjithashtu janë realizuar 19 aktivitete jashtë vendit dhe 17 trajnime brenda vendit, ndër të tjera dhe webinarë informuese nga ASPA, si dhe është trajnuar pothuaj i gjithë stafi teknik i institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezultojnë të jenë trajnuar më shumë se një herë. Të gjitha trajnimet jashtë vendit janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me RCC, OECD, KE, ABA, UNCTAD, TAIEX, Komuniteti i Energjisë dhe ato brenda vendit nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA).

PJESA E DYTË


ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS

AK, gjatë vitit 2024, ka realizuar monitorime dhe procedura hetimore në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëmbajtjen e konsumatorit:

- 11 (njëmbëdhjetë) monitorime:
 - Tregu i shitjes së bukës;
 - Tregu i operimit të agjencive doganore që operojnë pranë Portit Detar Durrës;
 - Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve;
 - Tregu i sigurimit të jetës për kredi;
 - Tregu i shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi;
 - Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport;
 - Tregu i tregtimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë;
 - Tregu i shërbimit spitalor;
 - Tregu i shërbimeve bankare;
 - Tregu i industrisë së turizimit;
 - Tregu i tregtimit të produkteve të shportës ushqimore.

- 8 (tetë) procedura hetimore:
 - Tregu i prodhimit, shitjes së nënprodukteve të qumështit;
 - Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve;
 - Tregu i prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK;
 - Tregu i prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK;
 - Tregu i prodhimit/ importit dhe shitjes me shumicë të çimentos;
 - Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës;
 - Tregu i sigurimit të jetës për kredi;
 - Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës.

2.1 Tregjet e monitoruara



- Tregje të monitoruara që nuk kanë kaluar në procedura hetimore
- Tregje të monitoruara dhe të kaluara në procedurë hetimore
- Tregje të monitoruara në zbatim të VKK 2022 dhe 2023
- Monitorime në vazhdim

AK, në zbatim të nenit 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121/2003, ka vlerësuar në total 39 ankesa, nga të cilat, 8 prej tyre kanë kaluar në procedura monitorimi/hetimi dhe pjesa tjetër kanë qenë jashtë objektit të ligjit nr. 9121/2003, të paraqitura si më poshtë:

2 (dy) Tregje të monitoruara që nuk kanë kaluar në procedura hetimore

- Tregu i shitjes së bukës

Nisur nga informacione mediatike në lidhje me njoftimin e furrave të bukës për rritjen e çmimit të bukës, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me Urdhërin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 60, datë 01.11.2024, “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e çmimit të prodhimit dhe tregtimit të bukës pas hyrjes në fuqi të vendimit të ERE””, u ngrit grupi i punës përgjegjës për monitorimin e çmimit të prodhimit dhe tregtimit të bukës.

Në zbatim të këtij urdhëri, u kryen monitorime në terren në qytetin e Tiranës pranë subjekteve “Furra buke”, nga ku rezultoi se nga data 1 nëntor 2024 nuk ka asnjë rritje të çmimit të energjisë elektrike për furrat e bukës, si dhe furrat e bukës nuk kanë ndryshuar apo rritur çmimin e bukës, duke mos u ndodhur para një sjelljeje të mundshme antikonkurruese nga ana e këtyre subjekteve, në kuptim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Tregu i operimit të agjencive doganore që operojnë pranë Portit Detar Durrës

AK vlerësoi ankesën e Agjencive Doganore që operojnë në Portin e Durrësit lidhur me rishikimin e tarifës së qerasë së zyrave të reja të agjensive doganore që operojnë pranë Portit Detar Durrës. AK kërkoi informacion pranë Agjencive Doganore, Autoritetit Portual të Durrësit, ndërmarrjes Albanian Seaports Development Company SHA, si dhe ka ftuar Agjencitë Doganore në një takim konsultativ, të cilët nuk janë paraqitur. Në përfundim të vlerësimit të ankesës rezultoi se veprimtaria e Albanian Seaports Development Company SHA në lidhje me marrëdhënien kontraktuale për dhënie me qera të zyrave modulare dhe agjencive doganore, nuk është objekt i shqyrtimit të ligjit nr. 9121/2003.

2 (dy) Tregje të monitoruara dhe të kaluara në procedurë hetimore

- Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve për analizimin e kushteve të këtij tregu. Pas monitorimit të tregut u konstatua se referuar strukturës së tregut, integritimit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, mund të jemi para një sjelljeje antikonkurruese si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen

e konkurrencës”. Per këto arsye KK vendosi hapjen e hetimi paraprak në këtë treg për qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

- *Tregu i sigurimit të jetës për kredi*

AK, ka vlerësuar kërkesën e ndërmarrjes SiCRED SHA, për fillimin e procedurave hetimore për të shmangur pengimet, kufizimet, shtrembërimet e konkurrencës në tregun e sigurimeve të jetës për kredi, duke nisur procedurat e monitorimit në këtë treg në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003.

Nga vlerësimi i informacionit të administruar gjatë monitorimit, si dhe nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u konstatua se shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit të jetës janë: Sigal Life Uniqa Group Austria SHA, Insig Jeta SHA, Albsig Jetë SHA dhe Sicred SHA.

Pothuajse të gjitha bankat janë të licensuara si “Broker” në sigurime nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me përjashtim të Bankës Amerikane të Investimeve SHA, First Investment Bank SHA edhe ProCredit Bank SHA. Megjithatë jo të gjitha aplikojnë sigurimin e detyrueshëm të jetës në rast huamarrje.

Gjatë monitorimit vihet re se, bankat e licensuara si “Broker” paraqesin portofolin e shoqërive të sigurimit me të cilat kanë kontrata aktive, dhe më pas lejojnë klientët të bëjnë përzgjedhjen e tyre pasi u janë shpjeguar kushtet e ndërmjetësimit përsa i përket produktit të sigurimit të jetës. Pavarësisht shpjegimit të sjellë në mënyrë shkresore nga bankat e nivelit të dytë, rezulton se përqindja e tregut total të sigurimit të jetës sipas raportit statistikor të AMF për vitin 2023, nuk reflektohet tek ndarja e portofolit të sigurimit të jetës për hua, ku SiCRED SHA rezulton të ketë përqindje tregu të tilla si 0.3% tek BKT SHA, 0.3% tek Raiffeisen bank SHA, 0.1% tek Intesa San Paolo bank SHA, 1% tek Pro Credit bank SHA etj. Nisur nga fakti që një përqindje e tillë tregu për një produkt të vetëm, nuk reflekton ndarjen totale të tregut të sigurimit të jetës, mund të vijë si pasojë e sjelljeve përjashtuese me karakter antikonkurrues, duke bërë që klientët mos të jenë të lirë të zgjedhin sigurimin e jetës për kredi nga shoqëri sigurimi të përzgjedhura nga vetë ata.

Për këto arsye, KK, me vendimin Vendim nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”, vendosi për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg. Hetimi përfshin periudhën kohore nga 07.11.2021 deri në 07.11.2024, dhe është në proces.

2 (dy) Tregje të monitoruara në zbatim të VKK 2022 dhe 2023

- *Tregu i shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi*

KK, me vendimin nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshtokollave”, Shoqatës së Autoshtokollave

“Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” (në vijim VKK nr. 970/2023), ka vendosur:

- I. Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, e lidhur ndërmjet palëve: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave”, Shoqata e Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vlerësohet si një akt marrëveshje në kundërshtim me nenin 4 të ligjit 9121.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- II. Monitorimin e tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtimimit, dëshmisë ose çertifikatës, për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- III. Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të rëndë të konkurrencës në kuptim të nenit 74, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 9121/2003.

AK, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, si dhe pikës II të VKK nr. 970/2023, ka nisur procedurat për monitorimin e tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtimimit, dëshmisë ose çertifikatës, për një periudhë 1 (një) vjeçare. Monitorimi përfshin periudhën kohore nga 24 Mars 2023 deri më 24 Mars 2024.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me monitorimin, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe janë realizuar monitorime në terren pranë subjekteve Autoshkolla dhe takime me përfaqësues të Shoqatës “Kombëtare të autoshkollave” dhe Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë”.

Në përfundim të procedurës së monitorimit të tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtimimit, dëshmisë ose çertifikatës, rezulton se, nga ana e subjekteve Autoshkolla është zbatuar pika I e VKK nr. 970/2023, duke mos aplikuar rritjen e tarifave sipas Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023.

Bazuar sa më sipër, KK, me vendimin nr. 1071, datë 19.04.2024, “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, vendosi mbylljen e procedurës së monitorimit të zbatimit të VKK nr. 970/2023.

- *Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport*

KK, me vendimin nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, gjatë ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si dhe detyrimin e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese.

AK, në vijim të monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të pikës III të dispozitivit të vendimit të VKK nr. 921/2022, ka kërkuar informacion ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK.

Nga informacioni i administruar gjatë monitorimit të të VKK nr. 921/2022, ka rezultuar se: lidhur me zbatimin e pikës III/a të VKK nr. 921/2022, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk ka hartuar një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepas-it; lidhur me zbatimin e pikës III/b të VKK nr. 921/2022, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk zbaton tarifa të orientuara drejt kostos, ky fakt përforcohet edhe nga mos zbatimi i një metodologjie apo prej normave të fitimit mbi 40%; lidhur me zbatimin e pikës III/c të VKK nr. 921/2022, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka zbatuar kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas dhe nuk ka paraqitur arsye për këtë trajtim të ndryshëm.

Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK” , vendosi:

- I. Vijimin e monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen “Star Parking Albania SHPK”, edhe për një periudhë 1 vjeçare.
- II. Gjorbitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën III të VKK nr. 921/2022, në masën 756,581 Lekë (shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) Lekë.

5 (pesë) Monitorime në vazhdim:

- *Tregu i tregimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë*

AK, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, vendosi të realizojë monitorimin e tregut të tregimit, përpunimit dhe ambalazhimit të kafesë dhe analizimin e kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Për mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të nevojshme lidhur me monitorimin e këtij tregu, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në lidhje me sasinë e importuar sipas kategorisë së kafesë për subjektet importuese që prej datës 1 janar 2023 e në vazhdim, si dhe nga Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për subjektet tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e përpunimit dhe tregimit të kafesë.

Duke qënë se nga analizimi të dhënave të administruara u vu re një trend rritës i çmimeve të

kafesë së importuar si dhe nga njoftimet në medien e shkruar lidhur me një rritje të pritshme të çmimit të kafes në bare dhe restorant, ky treg do të vijojë të mbahet në monitorim nga AK.

- *Tregu i shërbimit spitalor*

AK, në zbatim të rekomandimit të dhënë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022” dhe Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023” nga Kuvendi i Shqipërisë, me Urdhrin nr. 46, datë 24.10.2023 “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e tregut të shërbimit spitalor privat””, ka filluar procedurën e monitorimit të këtij tregu.

Në kuadër të monitorimit, për të mbledhur informacion dhe për të adresuar problemet e duhura, grupi i punës ka realizuar një takim me përfaqësues të Qendrës Spitalore Universitare Tiranë.

Në zbatim të nenit 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, AK i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të kërkuar informacion në lidhje me listën e spitaleve jopublike, gjithashtu i është drejtuar spitaleve jopublike për të marrë informacion mbi tarifën për disa shërbime dhe paketat që këto spitale ofrojnë, metodologjinë e llogaritjes së kostos për këto shërbime. AK ka realizuar një kërkesë për informacion (RFI) në rrjetin OECD-GVH/RCC dhe vende të tjera me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi në lidhje me disa shërbime mjekësore që ofrohen në spitalet private, për ndonjë procedurë hetimore/monitorimi të iniciuar prej tyre, çmimet e këtyre shërbimeve, si dhe ndonjë akt ligjor apo ndonjë ndërhyrje të shtetit që rregullon këto tregje dhe çmime. Gjithashtu me qëllim realizimin e një benchmark-u rajonal të çmimeve, i është drejtuar me anë të emailit disa prej spitaleve private të vendeve të rajonit (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Greqi dhe Itali) duke kërkuar informacion mbi tarifën e ofrimit të disa shërbimeve spitalore si dhe ka dërguar disa kërkesa për informacion (email) në spitalet e rajonit dhe në vende të tjera.

Në vijim AK i është drejtuar spitaleve private mbi shërbimet ekskluzive spitalore si dhe tarifën përkatëse.

Autoriteti i Konkurrencës është duke vijuar monitorimin e këtij tregu.

- *Tregu i shërbimeve bankare*

AK, në zbatim të rekomandimit të dhënë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023” nga Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121/2003, ka nisur me monitorimin e tregut të shërbimeve bankare. AK i është drejtuar bankave të nivelit të dytë duke kërkuar informacion mbi tarifën dhe komisionet e shërbimeve bankare të vendosura mbi tërheqjen e parave në bankomatet e bankave të cilat operojnë në Bashkinë Sarandë, si dhe ka realizuar disa takime konsultative me disa nga bankat dhe me Shoqatën e Bankave sipas problematikve të shfaqura gjatë përpunimit të informacionit të administruar.

Nga monitormi u konkludua se, në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003, asnjë nga bankat

nuk ka pozitë dominuese në këtë treg. Klientët kanë mundësi të zgjedhin lirisht në cilin bankomat të kryejnë tërheqjet e tyre, duke mos u kufizuar nga banka në të cilën kanë llogarinë bankare. Asnjë bankë nuk aplikon komision për tërheqjet në rrjetin e tyre të bankomateve, për kartat e lëshuara nga bankat e tjera vendase.

Tarifat dhe komisionet e aplikuara nga bankat për tërheqjet me karta ndërkombëtare, si dhe për tërheqjet e klientëve të tyre në bankomatet e bankave të tjera ndryshojnë midis bankave, por diferencat nuk janë domethënëse. Bankat që përdorin rrjete të nënkontraktuara zakonisht aplikojnë tarifa më të larta për këtë shërbim.

E njëjta gjë vlen dhe për aplikimin e mark-up, si një përqindje shtesë për ofrimin e Shërbimit të Këmbimit Dinamik të Valutës (DCC), i cili është një shërbim opsional që u ofrohet klientëve me karta të huaja, duke i lejuar tërheqjen e parave në monedhën origjinale të kartës me një kurs këmbimi të aplikuar nga banka.

Si përfundim, nuk u ngritën dyshime të arsyeshme se në tregun e ofrimit të shërbimeve bankare në bankomatet në Bashkinë Sarandë të këtë problematika apo elementë të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i industrisë së turizimit.*

Në kuadër të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024”, nëpërmjet të cilës i është kërkuar Autoritetit “Monitorimi i ndërmarrjeve që operojnë në industrinë e turizmit”, AK në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, ka nisur procedurën e monitorimit të ndërmarrjeve që operojnë në këtë industri.

AK, i ka kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Gjithashtu u vlerësua i rëndësishëm dhe identifikimi i subjekteve (fizike dhe juridike), të cilët gjatë vitit 2024 kishin nënshkruar Kontratën për Përdorimin e Hapsirës së Plazhit/Kontratë Qiraje të ndodhur nën juridiksionin e: Bashkisë së Durrësit, Kavajës, Vlorës, Himarës, Sarandës dhe Shkodrës dhe për këtë informacion iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Nga informacioni i dërguar nga DPT dhe AKB, AK arriti të identifikonte strukturat akomoduese të cilat kishin xhiron më të lartë dhe sipërfaqen më të madhë të zënë buzë detit për vitin 2023 në Bashkitë e Durrësit, Tiranës, Kavajës, Vlorës, Himarës, Sarandës dhe Shkodrës. Me identifikimin e tyre, ishte e rëndësishme të identifikoheshin dhe termat e ekskluzivitetit që këto struktura akomoduese kishin me agjensi shqiptare ose të huaja, për të parë nëse ka shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

Si përfundim, nuk u evidentuan prova apo nuk ngrihen dyshime të arsyeshme se për ndërmarrjet që operojnë në industrinë e turizmit të këtë problematika apo elementë të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të ligjit nr. 9121/2003.

- *Tregu i tregimit të produkteve të shportës ushqimore*

AK, gjatë muajit dhjetor 2024, në kuadër të angazhimit për mbrojtjen e konkurrencës dhe interesave të konsumatorëve, realizoi monitorim të menjëhershëm në terren për çmimet e produkteve të shportës ushqimore gjatë periudhës së festave të fund vitit, me qëllim evidentimin, parandalimin dhe penalizimin e atyre ndërmarrjeve tregtare të cilat abuzojnë me çmimet në shkelje të ligjit nr. 9121/2003. Ky monitorim do të zgjasë deri në 15 Janar 2025.

2.2 Marrëveshje të ndaluara

MARRRËVESHJE TË NDALUARA

TREGU I PRODHIMIT, SHITJES SE NËNPRODUKTEVE TE QUMËSHITIT;

TREGU I GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE;

**TREGU I PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK
DHE LI.BO - ALBANIA BRANCH SHPK;**

**TREGU I PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE ADASTRA SHPK
DHE COLOMBO SHPK.**

- *Tregu i prodhimit, shitjes se nënprodukteve te qumështit*

KK, me vendimin nr. 1052, datë 25.01.2024, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)”, duke marrë shkas edhe nga disa njoftime mediatike të ditëve të fundit, për protesta të zhvilluara nga blegtorët, sidomos në zonat e Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës, Delvinës, Tepelenës, Përmetit, Fierit etj, për çmimin e blerjes së qumështit nga ana e grumbulluesve dhe fabrikave përpunuese të qumështit, vendosi zgjatjen e periudhës kohore përcaktuar në pikën “II”, të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)”, me 6 (gjashtë) muaj duke përfshirë periudhën 1 janar 2024 deri në 30 qershor 2024.

Pas procedurave hetimore KK, me vendimin nr. 1131 datë 7.11.2024 “ Për mbylljen e

procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit (djath dhe gjalpë)” në vijim të mbylljes së hetimit, vendosi:

I. T’i rekomandojë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit:

Të përforcojë rolin e tij për zbatimin me rigorozitet të kontrolleve përsa i përket cilësisë dhe parametrave mikrobiologjikë të qumështit si lëndë e parë.

II. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave:

Të ndërmarrë nisma për një “Strategji të integruar në luftën kundër informalitetit” si insitucioni kompetent dhe përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e informalitetit në treg.

III. T’i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që:

- Të ndërmarrë nismën për hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 9441, datë 11.11.2005, me qëllim rregullimin e tyre dhe rritjen e konkurrencës në treg, bazuar në problematikat e konstatuara në tregun e prodhimit dhe tregtimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij;
- Të ndërmarrë nismën për krijimin e një baze të dhënash për monitorimin e çmimeve me pakicë të produkteve të shportës (nënprodukteve të qumështit), me qëllim rritjen e konkurrencën përmes transparencës dhe krahasueshmërisë më të mirë të këtyre çmimeve online.

- *Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve*

KK, me vendimin nr. 1085, datë 14.06.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë” vendosi hapjen e hetimit paraprak për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore nga 1 Janar 2023 deri në 31 Maj 2024.

Pas analizimit të strukturës së tregut, integritit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, u vlerësua se ky treg mund të ketë sjellje antikonkurruese. si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

KK, me vendimin nr. 1114, datë 04.10.2024 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, berat, Fier dhe Korçë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar, i cili do të përfshijë periudhën kohore 1 Janar 2023 – 30 Shtator 2024.

- *Tregu i prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK*

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) nëpërmjet shkresës nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023

(protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023), depozitoi Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.Bo - Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023”.

Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga KPP, u ngritën dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe digjitale të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ka elementë të një sjelljeje antikonkurruese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1000, datë 17.07.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK” vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg, për periudhën kohore nga 26 shtator 2022 deri në 17 korrik 2023.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, KK vlerësoi se bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, në tregun e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ngre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.

Për këto arsye, KK me Vendimin nr. 1026, datë 26.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg për periudhën 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.

Për shkak të mënyrës se si ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK kryejnë aktivitetin në Shqipëri, duke qenë se Li.Bo ka qenë furnitor i Raimondo G.P SHPK si dhe gjithashtu për shkak se gjatë procedurës së inspektimit nuk janë gjetur evidenca direkte, për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar midis ndërmarrjeve, KK në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar vlerësoi se, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e prokurimit me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo – ALBANIA të ketë shkelje të nenit 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1049, datë 16.01.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.Bo-Albania Branch SHPK, dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.Bo-Albania Branch SHPK”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK.
- II. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që brenda 90 ditëve të realizojnë ndryshimet përkatëse për të kryer një aktivitet të pavarur nga njeri tjetri dhe konkretisht:
 - i. Të ndryshojnë selinë e ushtrimit të aktivitetit;
 - ii. Të kenë adresa e-mail dhe numra telefoni të pavarur nga njëri tjetri;
- III. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që kur marrin pjesë individualisht në procedurat e prokurimit publik të ofertojnë në mënyrë të pavarur.

- *Tregu i prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK*

Agjencia e Prokurimeve Publike (APP) nëpërmjet shkresës nr. 3321/1 prot., datë 27.05.2024, (protokolluar pranë AK me nr. 388 prot., datë 28.05.2024), ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, një rast mbi dyshimin për marrëveshjeje në oferta midis operatorëve ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit.

Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga APP, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, dhe informacionit të Qendrës së Personel Rekrutimit, mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë, vihet re:

- Ndërmarrja Adastra SHPK ka paraqitur “Deklaratë për paraqitje oferte e pavarur”, të plotë dhe të nënshkruar.
- Autorizim i datës 24.04.2024, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Reparti Ushtarak nr. 6670 Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”.
- Z. Petrit Levendi është administrator dhe ortak i vetëm ndërmarrjes Colombo SHPK, gjithashtu pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.
- Ndërmarrja Adastra SHPK dhe ndërmarrja Colombo SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
- Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Adastra SHPK gjendet, vërtetim debie i datës 03.04.2024 “Për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, për personat juridik të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit lidhur me ndërtimet e reja”, vërtetim i lëshuar me kërkesën e ndërmarrjes Colombo SHPK.

Për sa më sipër, u ngritën dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit, ka elementë të një sjelljeje antikonkurruese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK, me Vendim nr. 1089, datë 21.06.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK”, vendosi për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 21.06.2024.

Gjatë hetimit paraprak, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe bazuar në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Adastra SHPK dhe Colombo SHPK në tregun e prokurimit publik për shpenzime kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, u hodhën dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.

Për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1122, datë 23.10.2024, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK” vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg për periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 23.10.2024.

Në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar, u konstatua se, skema e marrëveshjes në oferta e përdorur nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK në tregun e prokurimit publik për shpenzime kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., është ajo e ofertës së mbuluar, e cila është dhe forma më shpesh e përdorur, në të cilën gjenden të implementuara skemat e marrëveshjeve të ndaluara në oferta. Sipas kësaj skeme, njëri nga konkurrentët pranon të paraqesë një ofertë më të lartë sesa oferta e fituesit të përcaktuar, me qëllim për të dhënë përshtypjen e një ofertë të pastër dhe një konkurrencë të sinqertë, si dhe skema e ofertës së përmbajtur e cila përfshin marrëveshjet midis konkurrentëve në bazë të të cilave një apo më shumë firma bien dakort që të përmbahen nga oferta (mos ofertojnë), apo të tërhiqen nga një ofertë e paraqitur në mënyrë që oferta e përcaktuar fituese në marrëveshje të pranohet si e tillë.

Si përfundim, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe bazuar në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Adastra SHPK dhe Colombo SHPK në tregun e prokurimit publik për shpenzime kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, përbën marrëveshje të ndaluar.

Për këto arsye, KK, me vendimin nr. 1038, datë 20.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së

hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, gjobitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.
- II. Gjobitjen e ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK për shkelje të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003, përkatësisht në masën 2% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në 122 275 Lekë për ndërmarrjen Adastra SHPK dhe në masën 1% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në 238 809 Lekë për ndërmarrjen Colombo SHPK.
- III. Detyrimin e ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, si vijon:
 - i. Ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre:
 - a) do të ofertojnë në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakort me asnjë konkurrent tjetër, në lidhje me: çmimet, metodat, faktorët apo formulat e perdorura për llogaritjen e çmimit, qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë, sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
 - b) do të operojnë me punonjësit e tyre, në mënyrë të pavarur si më sipër;
 - c) nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektit të veprimtarisë së shoqërive respektive, njëkohësisht me dy oferta të ndryshme.
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.

Monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.

2.3 Abuzimi me pozitën dominuese

ABUZIMI ME POZITËN DOMINUERE

TREGU I PRODHIMIT/ IMPORTIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË ÇIMENTOS

TREGU I AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT TË QARKUT TË TIRANËS;

TREGU I SIGURIMIT TË JETËS PËR KREDI;

TREGU I SHËRBIMIT TAKSI PËR UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS.

- *Tregu i prodhimit/ importit dhe shitjes me shumicë të çimentos*

KK, me vendimin nr. 895, datë 05.07.2022 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në këtë për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003. Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore 1 janar 2021 deri në 30 qershor 2022. Në përfundim të analizës së realizuar gjatë periudhës hetimore u konstatuan elementë të cilët mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 dhe për këto arsye, KK me vendimin nr. 969, datë 24.03.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë për periudhën kohore nga 1 janari 2019 deri në 31 mars 2023.

KK, me vendimin nr. 1091, datë 01.07.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë dhe gjorbitjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për abuzim me pozitën dominuese” vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë.
- II. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri.

III. Gjeditjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat gërma a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, në shumën 97,700,736 (nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) Lekë.

Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA, për një periudhë (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

- *Tregu i aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës*

KK, me vendimin nr. 1025, datë 13.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

Gjatë procedurës së hetimit paraprak dhe në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, sjellja e ndërmarrjeve të administrimit mund të përbënte abuzim me pozitën dominuese kryesisht nëpërmjet: refuzimit të aksesit të ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë këtë shërbim; zbatimit të kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe duke krijuar kushtet e favorshme për krijimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve të internetit brenda rezidencës që ata administrojnë.

Si dhe, duke u nisur nga fakti se disa nga ndërmarrjet e administrimit kanë aksionarë të përbashkët me ndërmarrjet e internetit, dhe ushtrojnë veprimtarinë në të njëjtën rezidencë banimi, duke sjellë kështu një integrim vertikal, ngrihen dyshime që në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit mund të këtë shkelje të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi për hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.

Me Vendimin nr. 1087, datë 14.06.2024 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për refuzimin e pranimit të inspektimeve në mbështetje të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës”, KK vendosi gjeditjen e ndërmarrjes ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për shkelje të lehtë të konkurrencës, konkretisht të nenit 73, germa (c) dhe (ç) të Ligjit nr. 9121/2003, për arsye se gjatë inspektimit në këtë ndërmarrje, inspektorët e Sekretariatit u refuzuan për dhënien e çdo lloj informacioni që lidhej me objektin dhe qëllimin e inspektimit, në kundërshtimin me ligjin nr. 9121/2003.

Gjithashtu, në vijim të kërkesave për informacion ndaj të cilave ndërmarrja ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK nuk është përgjigjur, me Vendimin nr. 1099, datë 29.07.2024 “Kërkesë për sigurimin e informacionit nga ana e ndërmarrjes ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK”, KK me vendim vendosi t’i kërkojë kësaj ndërmarrjeje të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin e kërkuar në vijim të shkresave nr. 23/77 prot., datë 11.06.2024 “Kërkesë për informacion” dhe nr. 23/105 prot., datë 09.07.2024 “Rikujtesë mbi Kërkesë për

informacion nr. 23/77 prot., datë 11.06.2024”.

Në përfundim të analizës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit u konstatua se: sjellja e ndërmarrjeve Acrem SHPK, Park Construction Albania SHPK dhe S&D Invest SHA, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, nuk përbën abuzim me pozitën dominuese; sjellja e ndërmarrjeve Selcom SHPK dhe Albanian Satellite Communications SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të internetit nuk përbënte shkelje të nenit 4, të Ligjit nr. 9121/2003; sjellja e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK” në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, përbën abuzim me pozitën dominuese në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.

Për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1144 datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Acrem SHPK”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Acrem SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Acrem SHPK që brenda 90 ditëve të rishikojë nenin 5, pika 5.6 “Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënesit” në kontratat e bashkëpunimit e lidhura për shfrytëzimin e infrastrukturës së telekomunikacionit në kompleksin Rolling Hills, si një dispozitë e cila të mos kufizojë të drejtën e aksesit për ofrimin e shërbimit të internetit si dhe mos të jetë në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Acrem SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese, veçanërisht:
 - a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregimit;
 - b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
 - c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
- IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Acrem SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.
- V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Acrem SHPK, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të

Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.

KK, me Vendimin nr. 1141, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Park Construction Albania SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi për mbylljen e hetimit të thelluar në këtë treg për ndërmarrjen Park Construction Albania SHPK.

KK, me Vendimin nr. 1143, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen S&D Invest SHA”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes S&D Invest SHA në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja S&D Invest SHA si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si vijon:
 1. Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin që në rezidencat e administruara prej saj, të lejojë aksesin dhe për ndërmarrjet e tjera të cilat e kërkojnë këtë akses për të ofruar shërbimin e internetit.
 2. Ndërmarrja S&D Invest SHA ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese, veçanërisht:
 - a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
 - c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë
- III. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes S&D Invest SHA në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrja ka në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja S&D Invest SHA, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.

KK, me Vendimin nr. 1146, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Selcom SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi për mbylljen e hetimit të thelluar në këtë treg për ndërmarrjen Selcom SHPK.

KK, me Vendimin nr. 1147, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Albanian Satellite Communications SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi vendosi për mbylljen e hetimit të thelluar në këtë treg për ndërmarrjen Albanian Satellite Communications SHPK.

KK, me Vendimin nr. 1145, datë 27.12.2024, “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjëmbitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim.
- III. Gjëmbitjen e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në masën 6% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në 442,632 Lekë.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK që brenda 90 ditëve të rishikojë dispozitat e kontratave të lidhura me operatorët që ofrojnë shërbimin e internetit, të cilat mos të jenë në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa (c) dhe (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.
- V. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK, që në rezidencat e administruara prej saj, të lejojë aksesin dhe për ndërmarrjet e tjera të cilat e kërkojnë këtë akses për të ofruar shërbimin.
- VI. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK për të mos abuzuar me pozitën dominuese, veçanërisht:
 - e) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - f) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;

- g) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- h) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

VII. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit që ndërmarrjet kanë në administrim, për një periudhë 1 vjeçare.

VIII. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Administrim SHPK, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.

KK, me Vendimin nr. 1142, datë 27.12.2024, “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, vendosi për shtyrjen e hetimit të thelluar për ndërmarrjet D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit deri në 13.02.2025.

- *Tregu i sigurimit të jetës për kredi*

Pranë AK, është depozituar një kërkesë me nr. 523 prot., datë 30.07.2024 nga ndërmarrja SiCRED SHA, me qëllim fillimin e procedurave hetimore për të shmangur pengimet, kufizimet, shtrembërimet e konkurrencës në tregun e sigurimeve të jetës për kredi.

Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit, si dhe nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u konstatua se, shoqëritë e sigurimit të cilat ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit të jetës janë: Sigal Life Uniqa Group Austria SHA me 44.37%, Insig Jeta SHA 21.72%, Albsig Jetë SHA me 17.92% dhe Sicred SHA me 15.99% të tregut të sigurimit të jetës sipas raportit statistikor të vitit 2023.

Të gjitha bankat janë të licensuara si “Broker” nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përveç Bankës Amerikane të Investimeve SHA, First Investment Bank SHA edhe ProCredit Bank SHA, për ushtrimin e aktivitetit të brokerimit. Megjithatë jo të gjitha aplikojnë sigurimin e detyrueshëm të jetës në rast huamarrje.

Gjithashtu nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit vihet re se, bankat e licensuara si “Broker” paraqesin portofolin e shoqërive të sigurimit me të cilat kanë kontrata aktive, dhe më pas lejojnë klientët të bëjnë përzgjedhjen e tyre pasi u janë shpjeguar kushtet e ndërmjetësimit përse i përket produktit të sigurimit të jetës. Pavarësisht shpjegimit të sjellë në mënyrë shkresore

nga bankat e nivelit të dytë, rezulton se përqindja e tregut total të sigurimit të jetës sipas raportit statistikor të AMF për vitin 2023, nuk reflektohet tek ndarja e portofolit të sigurimit të jetës për hua ku SiCRED SHA rezulton të ketë përqindje tregu të tilla si 0.3% tek BKT SHA, 0.3% tek Raiffeisen bank SHA, 0.1% tek Intesa San Paolo bank SHA, 1% tek Pro Credit bank SHA etj. Nisur nga fakti që një përqindje e tillë tregu për një produkt të vetëm, nuk reflekton ndarjen totale të tregut të sigurimit të jetës, mund të vijë si pasojë e sjelljeve përjashtuese me karakter antikorrues duke bërë që klientët mos të jenë të lirë të zgjedhin sigurimin e jetës për kredi nga shoqëri sigurimi të përzgjedhura nga vetë ata.

Bazuar sa më sipër, sjellja e bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi mund të sjellë kufizim të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, KK, me vendimin Vendim nr. 1130, datë 07.11.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi”, vendosi për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg. Hetimi përfshin periudhën kohore nga 07.11.2021 deri në 07.11.2024, dhe është në proces.

- *Tregu i shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës*

KK, me Vendimin nr. 984, datë 11.05.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

Bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes se ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u vlerësua se mund të jemi përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër, KK, me Vendimin nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi:

- I. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, si vijon:
 - a. Lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
 - b. Të heqë tabelën me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, e cila ndalon dhënien e këtij shërbimi në shkelje të Ligjit nr. 9121/2003.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, u konstatua se, pavarësisht se ndërmarrja TIA ka zbatuar VKK nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, fakti që deri në momentin e konstatimit nga Autoriteti i Konkurrencës ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ka vendosur në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe

zona Kiss&Fly) tabelën me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, si dhe nuk ka lejuar ofrimin e shërbimit dhe taksive të tjera që operojnë në treg, brenda territorit të Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës, i cili për nga vet natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror si dhe kjo ndërmarrje është poseduese dhe administuese e vetme e infrastrukturës dhe faciliteteve të aeroporti ndërkombëtar të Tiranës, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, sjellja e TIA mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese duke refuzuar aksesin dhe ndërmarrjeve të tjera që janë të licensuara dhe që ofrojnë shërbimin e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi nga aeroporti drejt Tiranës apo një destinacioni tjetër.

Për sa më sipër, KK me vendimin nr. 1013, datë 13.09.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Në përfundim të hetimit të analizës së hetimit të thelluar, KK pasi shqyrtoi Raportin Hetimor të Sekretariatit, procesverbalin e grupit të punës lidhur me zbatimin e masave të përkohshme si dhe prapësimet e ndërmarrjes të paraqitura gjatë seancës dëgjimore konstaton se:

- i. Tirana International Airport SHPK, ka zbatuar vendimin për masat e përkohshme duke rivendosur konkurrencën në tregun përkatës të produktit me heqjen e tabelës “*Ndalohet taksi pa pasagjerë*” dhe lejimin e aksesit të taksive të tjera. Gjatë procedurës hetimore administrative nuk u provua lidhja shkak pasojë, pra veprimi i TIA në vendosjen e tabelës dhe pasojave që kanë rrjedhur nga kjo sjellje (Konkluzion i grupit të punës në Raportin Hetimor, pika 116 fq.27, bashkëlidhur foto nr.4 nga *Google Map- Maj 2016*).
- ii. Ka mospërputhje me tarifat e miratuara për shërbimin taksi për të saktësuar tregun gjeografik të shërbimit taksi nga/drejt aeroportit drejt/nga qyteti të Tiranës, pasi Auto Holiday Albania SHPK ndërkohë që është një ndërmarrje e licensuar nga Bashkia Krujë, përdor tarifat e miratuara nga Bashkia Tirane. Këto tarifa të cilat janë dhe të publikuara në faqen zyrtare të aeroportit TIA dhe të vetë AHA, janë fikse dhe jo në përputhje me bashkinë për të cilën është licensuar.

Për këto arsye, KK, me Vendimin nr. 1083, datë 06.06.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë, nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)”, vendosi:

- I. Të mbyllë procedurën e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë, nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

- II. T'i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që, për shkak të rëndësisë që paraqet Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA), si dhe në kuadër të shtimit të numrit të aeroporteve të tjera ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, të rishikojë rregullimin e nenit 37 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” si dhe aktet e tjera nënligjore në bazë të tij, për sa i përket detyrimit të nisjes së mjeteve pa pasagjerë jashtë bashkisë së licencimit, posaçërisht në lidhje me aeroportet ndërkombëtare.
- III. Tarifat për ndërmarrjen Auto Holiday Albania SHPK në zbatim të nenit 36 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të jenë në përputhje me tarifat e aplikuara nga bashkia në të cilën është licensuar.

2.4 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve

- *Tregu i sigurimeve për produktin kartoni jeshil*

KK, me vendimin nr. 904, datë 29.07.2022 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, vendosi përjashtimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil për një periudhë 2 (dy) vjeçare me kushte dhe detyrime.

AK në vijim të monitorimit të zbatimit të këtij vendimi ka bashkëpunuar me AMF, BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit duke kërkuar informacion për zbatimin e vendimit nr. 904/2022 për të gjithë periudhën e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes nga ku është konkluduar se shoqëritë e sigurimit: shoqëritë e sigurimit kanë zbatuar VKK nr. 904, datë 29.07.2022 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, duke vijuar me tregtimin e produktit të kartonit jeshil përmes operatorëve të licensuar nga AMF dhe çdo policë sigurimi ka të evidentuar qartë elementet identifikues të secilit operator: logo, nr serial, kodi i shoqërisë, vulën dhe nënshkrimin e operatorit, si dhe bar kod të skanueshëm, duke mos kufizuar të drejtën e konsumatorëve dhe klientëve për të zgjedhur produktin dhe duke ofruar shitjen e këtij produkti në të gjitha pikat e shitjes të shoqërisë në degë, ndërmjetës dhe pika të kalimit kufitar ku shoqëritë kanë pika shitje. Shoqëritë e sigurimit e tregtojnë produktin karton jeshil nëpërmjet pikave të shitjes dhe ndërmjetësve të licensuar nga AMF në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe çmimet e shitjes janë ato të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të cilat miratohen çdo vit për çdo shoqëri sigurimi me tabelat e primit të rrezikut për përlllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta, ku përfshihet edhe produkti i kartonit jeshil si dhe AMF miraton nivelin maksimal të komisioneve të ndërmjetësimit për këtë lloj sigurimi.

KK, me Vendimin nr. 1101, datë 29.08.2024 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, vendosi:

1. Të vazhdojë përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
2. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, dhe hyn në fuqi që nga momenti i depozitimit të kërkesës së BSHS për zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
 - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
3. T’i rekomandojë Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe ndërmarrjeve të sigurimit që të marrin masat për përgatitjen e kartonit jeshil në formatit elektronik PDF, sipas rekomandimeve nga Këshilli i Byrove.
4. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
5. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

2.4.1 Shtyrja e përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjeve.

- *Shtyrja e afatit të përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe SANOFI WINTHROP INDUSTRIE.*

KK, me vendimin nr. 905, datë 29.07.2022 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe SANOFI-AVENTIS GROUPE”, vendosi të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Distribucionit ndërmjet palëve Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe për një periudhë 2 vjeçare nga marrja e vendimit.

Në përfundim të periudhës së përjashtimit dhe në zbatim të nenit 50 “Vendimi për përjashtime individuale”, pika 4 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, palët në marrëveshje njoftuan për zgjatjen e Përjashtimit Individual të marrëveshjes.

Marrëveshja e njoftuar u klasifikua si një marrëveshje vertikale ekskluzive mes një furnizuesi dhe një distributori, e cila ka për qëllim shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike të gatshme dhe u vlerësua në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu për shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike të gatshme të klasave A10 dhe A16 sipas sistemit ATC (barna antidiabetikë).

Bazuar në nenet 48–52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pikën XI.1 parag. 76 dhe 161 i Udhëzimit “Mbi marrëveshjet vertikale”, marrëveshja e njoftuar nuk ka të parashikuar klauzola të cilat të fiksojnë çmimin, ndajnë tregjet apo kufizojnë prodhimin, sjellje këto të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003.

Tregu i produkteve Swixx me recetë (Rx) në Shqipëri nuk mbivendoset me klasat ATC3 të produkteve të Sanofit dhe për këto arsye Marrëveshja nuk ndikon në pjesëmarrjen në treg të Sanofit në lidhje me Produktet e Marrëveshjes.

Pas implementimit të Marrëveshjes, kushtet konkurruese të tregut do të mbeten të njëjta sepse Swixx Biopharma do të shpërndajë Produkte të Sanofit, brenda portofolit të produkteve që jepen me recetë nga mjeku, produkte të cilat më parë Sanofi i shpërndante përmes rrjetit të vet të shpërndarës në Shqipëri (shitësve me shumicë të autorizuar).

Periudha e propozuar për shtyrjen e përjashtimit të marrëveshjes, nuk pritet të sjellë ndryshime në strukturën e tregut dhe për këtë arsye miratimi i shtyrjes së përjashtimit nuk do të sjellë efekte mbi konkurrencën në treg.

Për këto arsye, KK me vendimin nr. 1077, datë 10.05.2024 “Për shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe SANOFI WINTHROP INDUSTRIE”, vendosi shtyrjen e afatit të përjashtimit deri në 1 janar 2027.

KONTROLLI I PËRQENDRIMEVE

TRANSAKSIONE NË TREGUN E BRENDSHËM

AK KA AUTORIZUAR 20 TRANSAKSIONE TË REALIZUARA NË TREGUN SHQIPTAR, TË CILAT TË DETAJUARA SIPAS TREGJEVE PARAQITEN SI MË POSHTË:

TREGU FARMACEUTIK;

TREGU FINANCIAR DHE I SIGURIMEVE;

TREGU I NDËRTIMIT DHE INFRASTRUKTURËS

TREGU I SHITJES ME SHUMICË DHE PAKICE I PRODUKTEVE
USHQIMORE DHE INDUSTRIALE;

TREGU I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE;

TREGU I PAJISJEVE ELEKTRONIKE, SOFTUERËVE DHE LOJËRAVE TË
FATIT;

TREGU I TELEKOMUNIKACIONIT, MEDIAVE AUDIOVIZIVE, CALL
CENTER.

TRANSAKSIONE NË TREGUN E JASHTËM

**AK KA AUTORIZUAR 33 TRANSAKSIONE TË REALIZUARA NË TREGUN E
JASHTËM.**

Në nenin 10, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003, parashikohet se përqendrimet të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e:


- a) Bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra –tjetra;
- b) Përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose aseteve, kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm;
- c) Kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit.

Një përqendrim, bëhet objekt shqyrtimi nga ana e AK, nëse përmbushet edhe kufiri i xhiros së parashikuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku parashikohet se “Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet, për të marrë autorizim, nëse, në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:

- a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar, është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.
- b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë”.


Gjatë vitit 2024 pranë AK janë njoftuar 65 transaksione, nga të cilat:

- 53 transaksione ka kaluar në procedurat e kontrollit të përqendrimeve dhe janë autorizuar nga KK në kuptim të nenit 56, pika 1 e ligjit nr. 9121/2003.
- 10 transaksione nuk kanë plotësuar kriteret e ligjit dhe janë kualifikuar si vlerësime ligjore.
- 2 transaksione janë braktisura nga palët pjesëmarrëse.




Referuar tregjeve të prekura nga transaksioni rezulton se:

- 33 vendime autorizimi janë transaksione që kanë ndodhur në tregun e jashtëm ;
- 20 vendime autorizimi janë transaksione, që kanë ndodhur në tregun shqiptar;



Tregjet më të prekura nga transaksionet kanë qenë: tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë (produkte ushqimore, bujqësore, industriale, plehra kimike, etj), tregu i prodhimit të energjisë elektrike, tregu financiar dhe i sigurimeve etj. Ndërkohë në tregun e brendshëm, transaksionet e autorizuar kanë prekur tregun farmaceutik dhe tregun e ndërtimit.



Në nenin 73, pika 1 germa b) dhe dh) të ligjit nr. 9121/2003, është parashikuar që KK vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 përqind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse:

- japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji;
- nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji (afati 30 ditor nga lidhja e kontratës/marrëveshjes).

Gjatë vitit 2024, KK ka marrë 3 vendime dhe ka vendosur 5 gjoba për shkelje të nenit 73, në vlerën totale 2.300.000 lekë dhe konkretisht:

- Vendimi nr. 1097 datë 11.07.2024 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 34% të kapitalit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA”;
- Vendimi nr. 1120 datë 11.10.2024 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë FARMACOM SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 33.33% të kapitalit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëria FARMACOM SHPK”;
- Vendimi nr. 1121, datë 11.10.2024, “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë PHARMA ONE SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA MED SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK”.

2.5.1 Transaksione në tregun e brendshëm

AK ka autorizuar 20 transaksione të realizuara në tregun shqiptar, të cilat të detajuara sipas tregjeve paraqiten si më poshtë:

- ***Tregu farmaceutik***

Në këtë treg janë vlerësuar 5 transaksione dhe konkretisht:

- *Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK nga shoqëria T-MEDSS SHPK, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1090 datë 01.07.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK nga shoqëria T-MEDSS SHPK, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj”.

Tregu përkatës, në këtë transaksion, u konsiderua tregu i shitjes së barnave.

Nga analiza e aktivitetit të shoqërive në transaksion si dhe shoqërive të lidhura me to, rezultoi se shoqëria MEGAPHARMA SHPK realizonte të ardhura nga shitja me shumicë e barnave të importuara, si dhe ishte e integruar në tregun e shitjes me pakicë, nëpërmjet kuotave që ortakët e saj zotërojnë në shoqërinë Orange Farmaci SHPK.

Shoqëria T-MEDSS SHPK ishte e licencuar për tregtim të aparateve dhe pajisjeve mjekësore, laboratorike e spitalore, por nuk ka patur aktivitet dhe nuk ka realizuara te ardhura gjatë vitit 2022.

Shoqëria e kontrolluar nga T-MEDSS, Labopharma SHPK, gjatë vitit 2022 nuk kishte realizuar importe të barnave, duke mos ndikuar në pjesën e tregut të shoqërisë target.

Përqendrimi mund të krijonte mbivendosje tregjesh në nivelin e importit dhe shitjes me shumicë të barnave midis aktivitetit ekonomik të shoqërisë target dhe shoqërisë Labopharma SHPK, por pa konstatuar efekte të ndjeshme për konkurrencën në këtë treg për vitin 2022 si rezultat i pjesës së vogël të tregut të shoqërisë target si dhe karakteristikave të strukturës së tregut të importit të barnave.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë MEGAPHARMA SHPK nga shoqëria T-MEDSS SHPK, Z. Robert Çina dhe Znj. Monika Hamzaraj.

- *Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1115, datë 11.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes së barnave.

Nga analiza e realizuar, u evidentua se shoqëria target, PHARMA ONE SHPK, operon në tregun

e shitjes me shumicë të barnave, por me një integrim vertikal në të gjitha nivelet e tregtimit të barnave.

Shoqëria blerëse MED LAB SHPK është licencuar për shitje-blerje të pajisjeve mjekësore e laboratorike, investime në fushën e laboratorëve mjekësore; import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore etj, por nuk ka patur aktivitet ekonomik.

Mbështetur në analizën e strukturave të tregut dhe tregjeve të prekura nga transaksioni, u konstatua se tregu i barnave dhe tregu i pajisjeve mjekësore mund të konsiderohen si tregje të lidhura për një tipologji të kufizuar të barnave, kryesisht për barnat parafarmaceutike apo materiale paramjekësore.

Shoqëria MED LAB SHPK nuk kishte kryer asnjëherë aktivitet ekonomik dhe blerja e kuotave në shoqërinë PHARMA ONE SHPK nuk do të sillte asnjë ndryshim në aktivitetin ekonomik të targetit, si dhe fuqinë e tij në tregun përkatës.

Përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje midis aktiviteteve të palëve (blerës dhe target) në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte ndryshime dhe nuk do të kishte ndikim në strukturat e tregut.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.

- *Përfitimi i kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1117, datë 11.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes së barnave.

Transaksioni i njoftuar u klasifikua si një përqendrim horizontal, pasi shoqëria blerëse dhe shoqëria target operojnë në të njëjtin treg përkatës. Për shkak të pjesës së vogël të tregut të shoqërisë target, u vlerësua se transaksioni nuk përbënte shqetësim për konkurrencën pasi nuk shfaqte shenja të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në treg.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

- *Përfitimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria EVITA SHPK dhe z. Ben Petani.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1118, datë 11.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria EVITA SHPK dhe z. Ben Petani.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes së barnave.

Transaksioni i përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga Z.

Petani dhe shoqëria Evita, nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave nga kjo e fundit, u klasifikua si një përqendrim horizontal pasi palët në transaksion operojnë në të njëjtin nivel tregtimi.

Nga vlerësimi i legjislacionit për barnat dhe shërbimin farmaceutik, u evidentua se tregu është i rregulluar në mënyrën e importit/prodhimit dhe tregtimit të barnave si dhe përcaktimin e marzhit të ndryshimit të çmimit dhe përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të tyre. Këto mekanizma e bëjnë të vështirë koordinimin e ndërmarrjeve për shkelje të mundshme të konkurrencës sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit.

Nga analiza e strukturës së tregut përkatës të produktit, u konstatua se pjesa e tregut të shitjes së barnave nga dy shoqëritë e prekura nga transaksioni ishte e vogël dhe përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe Z. Ben Petani, nëpërmjet blerjes së 50 % të kuotave nga Evita SHPK nuk do të sillte shqetësime për konkurrencën në treg, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria EVITA SHPK dhe z. Ben Petani.

- *Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1119, datë 11.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani.”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes së barnave.

Transaksioni i përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe Z. Ben Petani, nëpërmjet blerjes së 33 % të kuotave nga shoqëria FARMACOM SHPK, përbën një përqendrim konglomerat, pasi pala blerëse ka për objekt aktiviteti tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore, etj.

Pala blerëse, shoqëria FARMACOM SHPK, ishte një shoqëri e sapo krijuar dhe pa aktivitet në tregun e shitjes së barnave dhe ndërmarrjet PHARMA ONE SHPK dhe Evita SHPK nuk zotëronin, së bashku, pjesë të konsiderueshme në tregun përkatës të produktit në vitin 2019.

AK vlerësoi se transaksioni nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe nuk do të sillte asnjë efekt në strukturën e tregut të barnave pasi pjesa e tregut që zotërojnë shoqëritë Evita SHPK dhe PHARMA ONE SHPK do të mbetet e pandryshuar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani.

- Tregu financiar dhe i sigurimeve

Në këtë treg janë vlerësuar 4 transaksione dhe konkretisht:

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1047, datë 16.01.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimit të faktoring-ut nga Subjektet Financiare joBankë (SFJB).

Transaksioni i përftimit të kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A. u klasifikua si një përqendrim konglomerat, pasi ndërmarrjet që marrin pjesë në përqendrim operonin në tregje të ndryshme.

Shoqëria FAB INVEST SHPK ishte e pajisur më licencë për të ofruar shërbime faktoringu; shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimet e tjera ndihmëse për faktoringun; të gjitha format e kredihënies si Subjekt Financiar JoBankë (SFJB) dhe nga analiza e strukturës së tregut përkatës të produktit, u konstatua se ajo zotëronte një pjesë të vogël në këtë treg.

Shoqëria EUROSIG SHA dhe shoqëritë e kontrolluara prej saj, Insig SHA dhe INSIG JETE SH.A, ushtrojnë aktivitetin në tregun e sigurimeve, i cili funksionon në zbatim të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Mbështetur në të dhënat mbi primet e nënshkuara për sigurimin e jetës për periudhën 2022, marrë nga Raporti Vjetor i AMF-se, rezultonte se pjesa e tregut e shoqërisë INSIG JETE SH.A, në tregun e sigurimit të jetës, gjatë vitin 2022 ka qenë 18% dhe shoqëria paraqitej me tregues të mirë të aktivitetit ekonomik.

Nga analiza e tregjeve të lidhura, u konstatua se shoqëria EUROSIG SHA zotëronte të gjithë kapitalin aksionar të shoqërisë Banka e Bashkuar e Shqipërisë, një shoqëri e licencuar dhe që shtron aktivitet si bankë e nivelit të dytë në Shqipëri, por me një pjesë shumë të vogël në tregun e kredisë dhe depozitave.

Mbështetur në analizat e realizuara, AK konstatoi se asnjë nga palët e përfshira dhe të lidhura me transaksionin e përftimit të kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A., nuk ka një pjesë të ndjeshme tregu, duke mos sjellë shqetësime për konkurrencën nëpërmjet krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg dhe duke mos ndikuar në përjashtimin e konkurrentëve të tjerë nga tregu.

AK vlerësoi se një transaksion i tillë mund të sjellë eficensa dhe mund të ndihmojë shoqërinë target, FAB INVEST SHPK, të përmirësojë treguesit ekonomik, duke e bërë më konkurrues në tregun përkatës të produktit.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nga përftimi i kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A.

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë EUROSIG SHA nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK”.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1068, datë 29.03.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë EUROSIG SHA nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i sigurimeve (sigurimi i jetës dhe i jo jetës).

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat.

Shoqëria target, EUROSIG SHA, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, ushtronte aktivitetet në tregun e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës.

Në produktin e sigurimit të Jo-Jetës, shoqëria EUROSIG SHA ofronte shërbimet vetë dhe nëpërmjet shoqërisë INSIG SHA. Në tregun e sigurimeve të Jetës, EUROSIG SHA ofronte shërbimin e sigurimit të jetës nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar prej saj INSIG JETE SHA.

Shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK ushtronte aktivitetin kryesisht në sektorin e ndërtimit, prodhim, përpunim, tregtim të mallrave e materialeve të ndërtimit (pavarësisht se objekti i veprimtarisë së saj është më i gjerë, ku përfshihen dhe aktivitetet në sektorët e tregtisë së artikujve ushqimorë, industrialë, import – eksport të mallrave, etj.).

Palët pjesëmarrëse në transaksion ushtronin aktivitetet në tregje të ndryshme nga njëra – tjetra dhe për këtë arsye ky përqendrim nuk pritej të kishte ndikim në asnjërin prej tregjeve në të cilin operon secila nga shoqëritë. Transaksioni pritej të mos sillte shqetësime për konkurrencën në treg, duke mos ndikuar në përjashtimin e konkurrentëve të tjerë nga tregu apo në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese në treg.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë EUROSIG SHA nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK

- *Përfutimi i kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1134, datë 06.12.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK.”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimit të kredidhënies nga Subjektet Financiare Jo Banka (SFJB).

Referuar objektit të aktivitetit të shoqërive pjesëmarrëse në transaksion, transaksioni sillte mbivendosje të aktivitetit të shoqërive pjesëmarrëse në transaksion është tregu i kredidhënies, pasi të dyja shoqëritë, TRANZIT SHPK dhe NOA SHA janë të licencuara për të ofruar këtë shërbim. Për sa i përket faktoringut, qirasë financiare, mikrokredisë dhe shërbimeve të pagesave nuk ka mbivendosje të aktivitetit të shoqërive pjesëmarrëse në transaksion.

Nga analizat e realizuara, AK vlerësoi se transaksioni i njoftuar pritet të sjellë përfutime strategjike dhe operacionale për tregun përkatës, si diversifikimi i ofertës financiare, përmirësim të shërbimit për konsumatorët, më shumë mundësi për financimin e aktiviteteve bujqësore dhe konsumit dhe adresim më i mirë i nevojave të tregut. Duke integruar shërbimin e secilit subjekt, konsumatorët mund të përfitojnë nga një gamë më e gjerë produktesh financiare, të cilat do t'i ndihmojnë ata të optimizojnë menaxhimin e financave të tyre personale dhe të nevojave të

bizneseve të vogla.

KK konstatoi se transaksioni i përftimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK, do të krijonte mbivendosje horizontale ndërmjet aktivitetit të palëve në transaksion, por pa shfaqur shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK dhe do të mbajë në monitorim për një periudhë 1 vjeçare tregun e kredidhënies.

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë AMERICAN CAPITAL SHPK nga shoqëria ALBANIA LEASING SHA.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1139, datë 27.12.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë AMERICAN CAPITAL SHPK nga shoqëria ALBANIA LEASING SHA.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i qirasë financiare.

Transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim konglomerat pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operonin në tregje të ndryshme.

As shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK dhe as ndonjë nga shoqëritë e grupit, nuk ishin aktive në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë institucionet financiare jobankë.

Pas transaksionit, pjesa e tregut të shoqërisë ALBANIA LEASING, si një institucion financiar jobankë, nuk do të ndryshonte duke mos sjellë ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye transaksioni nuk do të sillte ndryshime të strukturës në tregun e qirasë financiare.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIA LEASING SHA nga shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK.

- ***Tregu i ndërtimit dhe infrastrukturës.***

Në këtë treg janë vlerësuar 3 transaksione dhe konkretisht:

- *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, LARTI - SHPK dhe FIX PRO SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1053, datë 02.02.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, LARTI - SHPK dhe FIX PRO SHPK.

Ndërmarrja e përbashkët Shtëpia e Pritjes SHPK do të ushtronte veprimtarinë e vet në qytetin e Korçës dhe palët do të ishin investitorë për ndërtimin e një sipërfaqe toke në këtë qytet.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i ndërtimeve.

Shoqëria AGNA SHA operonte kryesisht në tregun e shitjes me shumicë të mallrave ushqimorë

industrialë dhe duhanit të importuar dhe një pjesë e vogël e të ardhura realizohej nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme. Shoqëria LARTI – SHPK realizonte të ardhura kryesisht nga tregtimi i materialeve të ndërtimit dhe shoqëria FIX PRO SHPK ishte aktive kryesisht në prodhimin dhe tregtimin e sallamit dhe nënprodukteve të mishit.

Përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte ndryshime në tregun shqiptar.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, LARTI - SHPK dhe FIX PRO SHPK.

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1104 datë 29.08.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA”.

Tregu përkatës në këtë transaksion, u konsiderua tregu i projektimit, ndërtimit dhe menaxhimit të objekteve civile apo industriale për vete dhe për të tretë, dhe veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkte apo indirekte të lidhura me to.

Transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim konglomerat pasi shoqëria BOLV-OIL SHA dhe shoqëritë e zotëruara prej saj, operonin në tregje të ndryshme nga tregu i shoqërisë target.

Nga analiza e aktivitetit të shoqërisë blerëse dhe shoqërive të tjera të kontrolluara prej saj, u konstatua se BOLV OIL SHA ishte e integruar vertikalisht në tregun e magazinimit, importit, tregimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve, nëpërmjet shoqërive Porto-Romano OIL SHA dhe OLSI SHPK.

Shoqëria Target, SEASIDE RESIDENCE V SHPK, operonte në fushën e projektit dhe ndërtimit të objekteve civile apo industriale; menaxhimit e zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë; në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkte apo indirekte të lidhura me to, por nuk kishte realizuar asnjë të ardhur për 3 vitet e fundit.

Transaksioni i synuar do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, nuk do të sillte ndryshim dhe nuk do të kishte ndikim në strukturën e tregut të prekur nga përqendrimi në Shqipëri.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA.

- *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëritë ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe 2 T SHPK*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1111, datë 20.09.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimin të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të

plota, ECO CLEANING SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëritë ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe 2 T SHPK.

Ndërmarrja e Përbashkët, ECO CLEANING SHPK u themelua sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Shërbim i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit për Qytetin e Kamzës dhe transferimi te Autoriteti Kontraktor.

Treg përkatës në transaksionin e njoftuar u konsiderua tregu i shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit për qytetin e Kamzës.

Referuar aktivitetit të shoqërive të tjera të kontrolluara nga shoqëritë 2T SHPK dhe ALKO-IMPEX General Construction SHPK, konstatohet se asnjë prej tyre nuk ushtronte aktivitet në të njëjtin treg përkatës dhe për këto arsye transaksioni i krijimi të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota ECO-CLEANING SHPK, nga shoqëritë 2T SHPK dhe ALKO-IMPEX General Construction SHPK, nuk do të krijonte mbivendosje tregu dhe nuk do të ndryshonte pjesën e tregut të ndërmarrjes ECO-CLEANING SHPK në nivel kombëtar.

- ***Tregu i shitjes me shumicë dhe pakice i produkteve ushqimore dhe industriale***

Në këtë treg janë vlerësuar 3 transaksione dhe konkretisht:

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1059, datë 23.02.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes së produkteve shtëpiake të vogla, teleshopping.

SMA Holding SHPK operonte si një shoqëri holding dhe Studio Moderna Albania SHPK ishte një shoqëri aktive në fushën e teleshopping, import-eksport, tregti mallrash e shërbimesh.

Blerësi dhe Target ushtronin aktivitete të ndryshme tregtare, duke mos krijuar një mbivendosje të aktivitetit wt palwve tw pwrfskira nw transaksion dhe duke mos sjellw ndryshime në strukturën e tregut në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të kishte ndikim në strukturat e tregut.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK.

- *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përftimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1066, datë 19.03.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përftimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK”.

Ndërmarrje të përbashkët, Perutnina Ptuj Albania SHPK, u themelua sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti investime në industrinë e shpendëve, nëpërmjet blerjes së shoqërive, biznesit dhe asetëve dhe do të shërbente për të realizuar transaksionet e përfimit të kontrollit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i rritjes, mbarështimit dhe furnizimit me mish të shpendëve dhe nënprodukte të mishit të shpendëve, si dhe tregu i prodhimit të ushqimit të kafshëve.

Shoqëritë Driza SHPK operonte kryesisht në tregun e furnizimit me mish të freskët shpendësh; Fresh Chicken Albania 2019 SHPK operonte në tregun e rritjes së shpendëve për therje; Industria Foragjere (VEAF) SHA operonte në tregun e prodhimit të ushqimit të kafshëve dhe Euro Alb 2009 SHPK operonte në tregun e tregtimit të artikujve të ndryshëm të konsumit të gjerë.

Nga objekti i aktivitetit të shoqërive target, u konstatua se atoishin të lidhura midis tyre në proceset teknologjike, duke qenë pjesë e një zinxhiri, duke filluar nga mbarështimi i shpendëve, rritja e shpendëve për therje, furnizimi me mish të shpendëve dhe produkteve nga mishi i shpendëve, si dhe prodhimi i ushqimit të kafshëve.

Grupi Perutnina operon në tregun e shitjes së mishit të shpendëve dhe produkteve të mishit dhe shoqëria Balfin SHPK nuk ishte aktiv në tregjet ku operojnë shoqëritë target.

Nëpërmjet filialeve të saj (Spar SHPK dhe Tirana East Gate SHPK) Balfin mund të konsiderohet se vepron në mënyrë të tërthortë në një marrëdhënie vertikale me shoqëritë target.

Nga analiza AK konstatoi se transaksioni nuk krijonte mbivendosje të aktivitetit të palëve me tregun e rritjes, mbarështimit dhe furnizimit me mish të shpendëve dhe nënprodukte të mishit të shpendëve, si dhe në tregun e prodhimit të ushqimit të kafshëve dhe për më tepër në këto tregje operonin një numër i konsiderueshëm konkurrentësh, duke bërë që konsumatorët të kenë një gamë të gjerë zgjedhjesh.

Transaksioni i propozuar nuk do të krijonte apo forconte pozitën dominuese të ndonjërës nga palët pjesëmarrëse në transaksion në tregun përkatës të produktit, duke mos sjellë probleme për konkurrencën për sa i përket efekteve horizontale dhe vertikale.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përftimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.

- *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, HONEST BEER SHPK nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1092 datë 11.07.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, HONEST BEER SHPK nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha”.

Ndërmarrja e përbashkët HONEST BEER SHPK do të ishte përfaqësuese ekskluzive e Bitburger Braugruppe GmbH në Shqipëri. Ajo do t’i jepte të drejtën ekskluzive të distribucionit kompanisë CAPITAL RESOURCES SHPK, e zotëruar nga z. Sokol Kraja, për të shpërndarë produktet (birrën Bitburger, birrën Benediktiner dhe birrën Köstritzer), brenda territorit shqiptar.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i përfitimit dhe prodhimit të produkteve të së drejtës intelektuale dhe tregtimi apo dhënia në përdorim e tyre palëve të treta.

Shoqëria IDEL SHPK, e zotëruar nga z. Adnand Hoxha, ka qenë përfaqësuese ekskluzive e kompanisë Bitburger Braugruppe GmbH në Shqipëri, me të drejtë shpërndarje ekskluzive të produkteve të kësaj kompanie brenda territorit shqiptar.

Shoqëritë e kontrolluara nga ortakët e ndërmarrjes së përbashkët HONEST BEER SHPK operonin në tregje të ndryshme nga tregu i shitjes së birrës dhe për këtë arsye, nuk konstatohet të mbivendosej aktiviteti i ndërmarrjes së përbashkët me aktivitetet e shoqërive të tjera.

Ky përqendrim nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota HONEST BEER SHPK nga ortakët themelues të saj z. Sokol Kraja dhe z. Adnand Hoxha.

- ***Tregu i prodhimit të energjisë elektrike***

Në këtë treg janë vlerësuar 2 transaksione dhe konkretisht:

- *Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1095 datë 11.07.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK”.

GRABOVA HYDROPOWER SHPK do të krijohej si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti ndërtimin e Hidrocentralit mbi Lumin Grabovë, të tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero); prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-i mbi Lumin Grabovë; shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e kaskadës si më sipër gjatë periudhës koncesionare.

Tregu përkatës, në këtë transaksion, u konsiderua tregu i energjisë elektrike.

Palët në transaksion nuk ushtronin drejtpërdrejtë aktivitet në tregun e prodhimit të energjisë elektrike. Vetëm shoqëria AGNA SHA, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, kishte

prezencë juridike dhe realizonte të ardhura në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëria GRABOVA HYDROPOWER SHPK, ishte ende në fazën e ndërtimit të hidrocentralit dhe nuk ishte pajisur me licencë specifike për prodhimin e energjisë elektrike.

Në përfundim të analizës së konkurrencës, AK konstatoi se prezenca në tregun e prodhimit të energjisë elektrike e shoqërive të kontrolluara nga shoqëria AGNA SHA, nuk do të sillte shqetësime për konkurrencën, pasi pjesa e tregut që ato zotëronin ishte shumë e vogël dhe për më tepër nuk krijohet mbivendosje e pjesëve të tregut nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në transaksion apo ndërmarrjet e lidhura mes tyre.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota GRABOVA HYDROPOËER SHPK nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe ALB - STAR SHPK.

- *Përftimit i kontrollit të përbashkët të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëritë GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1096 datë 11.07.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimin të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 34% të kapitalit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOWER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA”.

Tregu përkatës, në këtë transaksion, u konsiderua tregu i energjisë elektrike.

Transaksioni i blerjes së 34% të kuotave të shoqërisë GRABOVA HYDROPOËER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA, indirekt, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara krijonte mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Pjesa e kombinuar e tregut e shoqërive të kontrolluara nga shoqëritë AGNA SHA dhe GJOKA KONSTRUKSION SHA përbënte 4.32% të prodhimit të energjisë nga Prodhues të Pavarur dhe ata me Përparësi dhe 1.74% e prodhimit total të energjisë së prodhuar në vend.

Shoqëria target, GRABOVA HYDROPOWER SHPK ishte ende në fazën e ndërtimit të hidrocentralit dhe nuk ishte aktive në tregun e energjisë elektrike, për pasojë nuk do të ndikonte në pjesën e tregut të shoqërive të kontrolluara nga ortakët e saj.

Transaksioni i njoftuar nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 34% të kapitalit të shoqërisë GRABOVA HYDROPOËER SHPK nga shoqëria GJOKA KONSTRUKSION SHA.

- ***Tregu i pajisjeve elektronike, softuerëve dhe lojërave të fatit***

Në këtë treg janë vlerësuar 2 transaksione dhe konkretisht:

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë Eagle Investment SHA nga shoqëria Infinity Investment SHA.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1054, datë 02.02.2024, “Mbi autorizimin e

përqendrimin të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Eagle Investment SHA nga shoqëria Infinity Investment SHA”.

Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i lojërave të fatit.

Infinity Investment SHA operonte në fushën e lojërave të fatit përfshirë të gjithë kategoritë, kazino elektronike, operim dhe menaxhim i sallave të lojërave të fatit dhe kazinove, import-eksport i makinave të lojërave të fatit, marrje dhe dhënie me qira e tyre etj.

Shoqëria Eagle Investment SHA ka qenë një shoqëri e licencuar në ofrimin e lojërave të fatit në salla, por pas ndalimit me ligj të këtij aktiviteti, target nuk kishte ushtruar aktivitet ekonomik në këtë treg. Të ardhurat e shoqërisë vinin nga dhënia me qira e automateve të lojërave të fatit shoqërive të treta të licencuara, si dhe dhënia me qira e ambienteve dhe sallave të saj.

Shoqëria target, Eagle Investment SHA nuk ka asnjë aktivitet tregtar lidhur me tregun e lojërave të fatit dhe transaksioni nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim në strukturat e tregut.

Për sa më sipër, KK vendosi të autorizonte përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Eagle Investment SHA nga shoqëria Infinity Investment SHA.

- *Përftimi i kontrollit të shoqërisë HORIZON SHPK nga Z. Ermal Beqiri.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1116, datë 11.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë HORIZON SHPK nga Z. Ermal Beqiri.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i teknologjisë së informacionit.

Z. Beqiri është zotërues i vetëm i shoqërisë SOFT & SOLUTION SHPK, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit; projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie web-site, etj.;

Shoqëritë SOFT & SOLUTION SHPK dhe HORIZON SHPK operojnë në segmente të ndryshme të zinxhirit të teknologjisë së informacionit ku produktet dhe shërbimet e ofruara prej tyre janë plotësuese të njëra - tjetrës dhe ndërveprojnë si pjesë e një sistemi më të gjerë.

Shoqëria target, HORIZON SHPK një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e teknologjisë, duke ofruar krijim dhe integrim të sistemeve të informacionit për shoqëri dhe individë; zgjidhje, shërbime mbështetëse; import-eksport, si dhe shitje të pajisjeve informatike, produkte hardware dhe software.

Transaksioni i njoftuar u klasifikua si një përqendrim konglomerat.

Nga analiza e realizuar AK konstatoi se asnjë prej shoqërive të zotëruara nga Z. Ermal Beqiri nuk operon në tregun e teknologjisë së informacionit. Shoqëritë SOFT & SOLUTION SHPK dhe HORIZON SHPK operojnë në segmente të ndryshme të tregut të teknologjisë së informacionit (mirëmbajtje harduer dhe shërbime softuerike), duke mos krijuar mbivendosje të produkteve dhe shërbimeve të ofruara prej tyre.

Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar nuk pritej të sillte ndikim në konkurrencën në treg.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë HORIZON SHPK nga Z. Ermal Beqiri.

- ***Tregu i telekomunikacionit, mediave audiovizive, call center***

Në këtë treg janë vlerësuar 2 transaksione dhe konkretisht:

- *Përfutimi i kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri.*

KK autorizoi përqendrimin me vendimin nr. 1112, datë 20.09.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri.”.

Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i komunikimeve elektronike në rrjetet fikse.

Nga analiza e realizuar, AK konstatoi se se shoqëria NSolution SHPK ka ushtruar aktivitet në tregun e komunikimeve elektronike nëpërmjet rrjeteve fikse dhe kryesisht në shërbimin e aksesit në internet dhe transmetim të dhënash, ndërkohë që shoqëria SOFT & SOLUTION SHPK ka ushtruar aktivitet në sektorin e teknologjisë së informacionit, kryesisht në prodhimin e programeve informatike.

Shoqëritë në transaksion nuk krijojnë marrëdhënie horizontale apo vertikale mes tyre, pasi ushtrojnë aktivitet në tregje të ndryshme. Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, KK vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë NSolution SHPK nga Z. Ermal Beqiri.

2.5.2 Transaksione në tregun e jashtëm

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 9121/2003, objekt i vlerësimit të përqendrimit janë transaksione, të cilat ndodhin në tregun e jashtëm, por që realizojnë të ardhura në tregun shqiptar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

KK, për vitin 2024, ka autorizuar 33 raste transaksionesh, të renditura si më poshtë:

1. Vendimi nr. 1046, datë 16.01.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët, nëpërmjet blerjes së aksioneve, të shoqërisë “SAV 92” nga shoqëritë Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding. Transaksioni ndodh në tregun e shitjes me shumicë të produkteve të konsumit të shpejtë dhe të produkteve kozmetike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
2. Vendimi nr. 1050, datë 25.01.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike dhe magazinimi i saj dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
3. Vendimi nr. 1051, datë 25.01.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët në shoqërinë MidOcean Holdings II L.P dhe indirekt në shoqërinë MidOcean Energy, LLC nga shoqëritë Aramco Overseas

Company B.V dhe EIG Management Company, LLC”. Transaksioni ndodh në tregun për kërkimin e gazit natyror dhe tregun për furnizimin me shumicë në rrjedhën e sipërme të gazit natyror dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

4. Vendimi nr. 1055, datë 02.02.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
5. Vendimi nr. 1056, datë 02.02.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë First Bank S.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A. Transaksioni ndodh në tregun e shërbimeve bankare dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
6. Vendimi nr. 1057, datë 12.02.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë WE SII S.r.l. nga Z. Mauro Migliuzzi, shoqëria Terna Forward S.r.l., dhe shoqëria DXT Commodities SA.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit, transmetimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen (O&M) dhe monitorimin e sistemeve fotovoltaike nga sensorë në largësi dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
7. Vendimi nr. 1058, datë 12.02.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë BTB Holding Investments S.A. nga shoqëria Ultima Holding S.A”. Tregu përkatës do të lihet i hapur, pasi Grupi Ultima është i përbërë kryesisht nga shoqëri financiare holding dhe ka aktivitete shumë të kufizuara biznesi si në sektorin e medias, ashtu edhe në tregun e pasurive të paluajtshme dhe transaksioni nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
8. Vendimi nr. 1062, datë 06.03.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Ford Motor Company, BMW (US) Holding Corp. dhe American Honda Motor Co., Inc.”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimeve të shërbimeve të rrjetit për shoqëritë e shërbimeve elektrike, nëpërmjet menaxhimit inteligjent të ngarkesës dhe grumbullimit të të dhënave të energjisë së automjeteve elektrike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
9. Vendimi nr. 1063, datë 06.03.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria Statkraft OIE d.o.o.”.

KK vendosi të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria Statkraft OIE d.o.o.” dhe autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të ishte i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.

Vendimi nr. 1073, datë 19.04.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria STATKRAFT OIE d.o.o.. Transaksioni ndodh në tregun

e prodhimit dhe ruajtjes së energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

10. Vendimi nr. 1065, datë 19.03.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët nga shoqëritë Miele Beteiligungs-GmbH (International Steel Co. S.p.A.) dhe Metall Zug AG (Belimed AG dhe Belimed Life Science AG), me kontroll të vetëm nga Miele”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe furnizimit të produkteve dhe shërbimeve të kontrollit të infeksioneve dhe parandalimit të infektiveve, me nën tregje të veçanta sipas llojeve të pajisjeve dhe grupeve të ndryshme të klientëve dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
11. Vendimi nr. 1067, datë 29.03.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Fortenova Group MidCo B.V. dhe tërthorazi mbi Fortenova Group nga shoqëria Open Pass Limited”. Transaksioni ndodh në tregun e produkteve ushqimore dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
12. Vendimi nr. 1074, datë 26.04.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Resity Technologies d.o.o. nga shoqëritë Messer Se & Co. KGaA dhe DELTA HOLDING DOO BEOGRAD”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve IT dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
13. Vendimi nr. 1076, datë 10.05.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Officine Maccaferri - S.P.A. nga shoqëria Ambienta SGR SPA nëpërmjet shoqërisë HoldCo 69 S.R.L”. Transaksioni ndodh në tregun për prodhimin dhe furnizimin e materialeve për inxhinierinë mjedisore dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
14. Vendimi nr. 1080, datë 24.05.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të tërthortë të asetëve në pronësi të KOMERCIJALNA BANKA AD nga shoqëria Yildirim International Investment Holding B.V.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe furnizimit të hekur nikel dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
15. Vendimi nr. 1086 datë 14.06.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të vetëm të shoqërive LG – LHT Aircraft Solutions GmbH, LG – LHT Passenger Solutions GmbH dhe AerQ GmbH nga shoqëria Lufthansa Technic AG”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve lidhur me projektimin, zhvillimin, dhe furnizimin e sistemeve të menaxhimit të kabinës (SMK) dhe të sistemeve të argëtimit në fluturim (ANF) për avionët tregtarë dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
16. Vendimi nr. 1088 datë 21.06.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfimit të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD”. Transaksioni ndodh në tregun e rigazifikimit të LNG përfshirë ngarkimin, ruajtjen, fleksibilitetin, matjen dhe shërbimet detare dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

17. Vendimi nr. 1098 datë 29.07.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TERMINALE GNL ADRIATICO S.R.L. nga shoqëritë VIKKA VTTI S.p.A. dhe SNAM S.P.A”. Transaksioni ndodh në tregun e infrastrukturës së importit të gazit dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
18. Vendimi nr. 1100, datë 29.07.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë DS SMITH PLC nga shoqëria INTERNATIONAL PAPER COMPANY”. Transaksioni ndodh në tregun e furnizimit të materialeve të paketimit të valëzuar/ kutive të kartonit të valëzuar/ paketimeve të ambalazhimit të valëzuar dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
19. Vendimi nr. 1102, datë 29.08.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Cura Domo Holding GmbH nga shoqëria Mavie Next GmbH”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimeve të kujdesit për të moshuarit dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
20. Vendimi nr. 1103, datë 29.08.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Immedica Pharma Holding AB nga shoqëritë KKR dhe Impilo No 4 AB”. Transaksioni ndodh në tregun e komercializimit të barnave për sëmundjet e rralla dhe specifike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
21. Vendimi nr. 1105, datë 29.08.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë VITA RES DOO nga shoqëria RAUCH Fruchtsäfte GmbH.”. Transaksioni ndodh në tregun e përpunimit të frutave dhe tregu i shitjes së produkteve gjysmë të gatshme dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
22. Vendimi nr. 1106, datë 06.09.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë PR-TELECOM Távközlési Kereskedelmi és Szolgáltató Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe filialit të saj PR-WORK Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság”. Transaksioni ndodh në tregun e komunikimeve elektronike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
23. Vendimi nr. 1107, datë 06.09.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë EDISON STOCCAGGIO SPA nga shoqëria SNAM S.P.A”. Transaksioni ndodh në tregun e infrastrukturës së gazit natyror dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
24. Vendimi nr. 1109, datë 16.09.2024 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë MARCEGAGLIA STEEL S.P.A. dhe MANNI GROUP S.P.A”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe tregtimit të (i) paneleve sanduiç me shkumë dhe fibra minerale për çati dhe mure dhe (ii) fletë të valëzuara dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
25. Vendimi nr. 1110, datë 20.09.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar

nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë GERMANI S.P.A. dhe filialit të saj TRASPORTI VECCHI ZIRONI S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. dhe MEGRANI S.R.L.”. Transaksioni ndodh në tregun e shërbimit të transportit të mbetjeve industriale dhe urbane dhe kategori të tjera, përfshi gazet teknike dhe karburantet dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

26. Vendimi nr. 1113, datë 04.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë KCA Deutag International Limited nga shoqëria HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED.”. Transaksioni ndodh në tregun e ofrimit të shërbimit të shpimit të puseve dhe shërbimeve inxhinierike dhe teknologjike të lidhura me to dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
27. Vendimi nr. 1123, datë 23.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë DELEPLANQUE ET COMPAGNIE nga shoqëria RAGT SEMENCES.”. Transaksioni ndodh në tregun për furnizimin e farërave dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
28. Vendimi nr. 1124, datë 23.10.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V.”. Transaksioni ndodh në tregun e prodhimit dhe shitjes së tankeve për transformatorë dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
29. Vendimi nr. 1127, datë 07.11.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD dhe biznesit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC nga shoqëria Robert Bosch GmbH. Transaksioni ndodh në tregun për sistemet HVAC dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
30. Vendimi nr. 1128, datë 07.11.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë V4Drive Battery GmbH nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.”. Transaksioni ndodh në tregun i zhvillimit dhe shitjes së qelizave të baterive litium-jon për aplikacione automobilistike dhe jo automobilistike dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
31. Vendimi nr. 1132, datë 14.11.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të Entiteteve të Grupit Vantive (Vantive Health LLC; Vantive Mexico LLC; Gambro Renal Products Inc; RTS Worldwide Holdings Inc; Vantive Holding BV; Vantive Health GmbH; Jersey NewCo) nga shoqëria CP Spruce Holdings, S.C.Sp.”. Transaksioni ndodh në tregun e furnizimit me produkte për terapi të zëvendësimit të veshkave dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
32. Vendimi nr. 1133, datë 14.11.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE.”. Transaksioni ndodh në tregun e furnizimit të dokumenteve të identitetit bosh dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.
33. Vendimi nr.1136, datë 06.12.2024, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të Biznesit të Transferuar nga shitësit tek

shoqëria blerëse DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság.”. Transaksioni ndodh në tregun e televizionit dhe komunikimeve televizive dhe nuk do të kishte ndikim në tregun shqiptar.

PJESA E TRETË

AUTORITETI I KONKURENCËS PËRBALLË PROCESIVE GJYQËSORE

AK i kushton rëndësi të veçantë ndjekjes së procedurave gjyqësore, duke qenë aktiv në të gjitha këto procese në shkallët e gjykimit nëpërmjet paraqitjes së argumenteve dhe provave në mbështetje të vendimeve të marra nga KK.

Ndjekja e çështjeve gjyqësore lidhet me ndikimin që kanë vendimet e KK në tregun përkatës dhe në publikun e gjerë, si dhe me faktin që pothuajse të gjitha vendimet e KK për marrje masash ndaj ndërmarrjeve, i janë nënshtruar procesit të ankimit në gjykatë.

3.1 Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjatë vitit 2024 AK ka patur në shqyrtim 9 (nëntë) çështje gjyqësore me objekt shfuqizimin e Vendimeve të KK, ku janë rrëzuar 4 (katër), pranuar 1 (një), dhe janë në proces gjykimi 4 (katër) kërkesë padi.

Proçeset gjyqësore me palë të paditur AK, të cilat janë rrëzuar nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i pikës 2 të VKK nr. 852, datë 24.12.2021 të Autoritetit të Konkurrencës “Për dhënie rekomandimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe dhënie detyrimi Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për rritjen e konkurrencës në ofrimin e shërbimit të auditimit ligjor”;
2. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ Miell Tirana” SHA dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr.935, datë 16.12.2022 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021” për pjesën e shoqërisë “Miell Tirana” SHA;
3. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Gega Oil Group” SHA dhe të paditur AK, me objekt : Shfuqizimi i VKK nr. 993, datë 08.06.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë Gega Oil Group SHA, për mos njoftim brenda afatit të përqëndrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje shoqërisë ‘Gega Oil SHA’ nga shoqëria ‘Genklaudis SHA’;

4. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Air BP Albania” SHA dhe të paditur AK, me objekt shfuqizimi i VKK nr.1005, datë 28.07.2023 “Për vendosje gjobe ndaj shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA për deklarim të të dhënave të paplota dhe të pasakta”.

Proçeset gjyqësore me palë të paditur AK, të cilat janë pranuar nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjet “Agha SHA”, “TID SHPK” dhe “Info-Telecom SHPK” dhe të paditur AK, me objekt: “Shfuqizimin e plotë/të pjesshëm të VKK nr. 1017 datë 25.09.2023 ‘ Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të shoqërive Agha SHA, Info-Telecom SHPK dhe TID SHPK, për gjobën e vendosur për mosnjohim brenda afatit, të përqëndrimit të realizuar për përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK”.

Proçeset gjyqësore me palë të paditur Autoritetin e Konkurrencës, të cilat janë në proçes gjykimi nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ Bloja” SHA dhe të paditur AK, me objekt: Shfuqizimi i VKK nr.935, datë 16.12.2022 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AgroBlend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA dhe Atlas Mills SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuara me VKK nr. 839, datë 29.09.2021” për pjesën e shoqërisë “Bloja” SHA;
2. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “ Neofon SHPK” dhe të paditur AK, me objekt: Ndryshim I pjesshëm i VKK nr.952, datë 28.12.2022 ‘Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: Tregu me shumicë I terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënien e disa detyrimeve”;
3. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Antea Cement SHA” dhe të paditur AK, me objekt: Anulim/shfuqizim I VKK nr.1091, datë 01.07.2024 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes së çimentos grid he të bardhë dhe gjobitjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për abuzim me pozitën dominuese”;
4. Çështja gjyqësore me palë paditëse ndërmarrjen “Star Parking Albania SHPK” dhe të paditur AK, me objekt: Ndryshim I VKK nr.1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të VKK nr.921, datë 09.11.2022 ‘Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit ‘Nënë Tereza’ dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”.

3.2 Çështje të gjykuara në gjykatën administrative të apelit Tiranë

Gjykata Administrative e Apelit, gjatë vitit 2024 ka shqytuar 1 (një) çështje me palë Autoritetin e Konkurrencës:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse shoqërinë “EMS Albanian Port Operator SHPK” dhe palë të paditur AK, me objekt: “Shfuqizimi teresisht i VKK nr. 451, datë 28.02.2017 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitet e lidhura me to për mallrat në Terminalin Lindo të Portit të Durrësit”. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3.3 Çështje të gjykuara në Gjykatën e Lartë

Gjykata e Lartë, gjatë vitit 2024 ka shqyrtuar 1 (një) çështje me palë Autoritetin e Konkurrencës:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse shoqërinë “Ultra Motors SHPK” dhe të paditur AK, me objekt: “Shfuqizimi i aktit administrativ VKK nr. 154, datë 01.10.2010 lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar në oferta”.

Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të shoqërisë Ultra Motors SHPK.

3.4 Ekzekutimi i vendimeve të komisionit të konkurrencës

- Komisionit të Konkurrencës për vitin 2024 ka marrë 8 (tetë) vendime me gjobë, si më poshtë:

NR.	VENDIMI I KOMISIONIT TË KONKURRENCËS	DEBITOR
1	1084/10.05.2024	STAR PARKING ALBANIA SHPK
2	1087/14.06.2024	ARLIS ADMINISTRIM SHPK
3	1091/01.07.2024	ANTEA CEMENT SHA
4	1097/11.07.2024	AGNA SHA
		GR ALBANIA SHPK
		GJOKA KONSTRUKSION SHPK
5	1120/11.10.2024	FARMACOM SHPK
6	1121/11.10.2024	PHARMA ONE SHPK
7	1138/20.12.2024	ADASTRA SHPK
		COLOMBO SHPK
8	1145/27.12.2024	TIRANA ADMINISTRIM SHPK

- Nga këto vendime janë ekzekutuar plotësisht 4 (katër), të cilave i përkasin 6 (gjashtë) debitorë.
- Autoriteti i Konkurrencës është në pritje të plotësimit të afatit të ekzekutimit vullnetar për 4 (katër) vendimet e tjera me gjobë të vitit 2024, të cilave i përkasin 5 (pesë) debitorë.
- AK është në pritje të kryerjes së veprimeve përmbarimore për 9 (nëntë) urdhra ekzekutimi të cilat i përkasin vendimeve të Komisionit të Konkurrencës përpara vitit

2024.

- Gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar plotësisht ose pjesërisht 11 (njëmbëdhjetë) vendime të Komisionit të Konkurrencës të cilat i përkasin viteve 2013-2024, si më poshtë:

NR.	VKK	NR.	DEBITORË	STATUSI
1	290/23.07.2013	1	“Ferlut” SHA;	Ekzekutuar pjesërisht
		2	“Tirana Lines” Shpk;	
		3	“Alba Trans” Shpk	
		4	“Tirana Urban Trans” SHA	
		5	“Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk	
2	572/22.11.2018	6	EKMA Albania shpk	Ekzekutuar pjesërisht
3	766/22.01.2021	7	New Medical Plus SHPK	Ekzekutuar pjesërisht
4	794/27.04.2021	8	MBM SHPK	Ekzekutuar plotësisht
5	935/16.12.2022	9	Miell Tirana SHA	Ekzekutuar pjesërisht
		10	Bloja SHA	
		11	Atlas Mills shpk	
6	1005/28.07.2023	12	Air BP Albania SHA	Ekzekutuar plotësisht
7	996/05.07.2023 1004/20.07.2023 1017/25.09.2023	13	Agna SHA	Ekzekutuar pjesërisht
		14	Info - Telecom SHPK	
		15	Tirana International Development SHPK	
8	1084/10.05.2024	16	Star Parking Albania shpk	Ekzekutuar plotësisht
9	1087/14.06.2024	17	Arlis Administrim shpk	Ekzekutuar plotësisht
10	1091/01.07.2024	18	Antea Cement SHA	Ekzekutuar plotësisht
11	1097/11.07.2024	19	Agna SHA	Ekzekutuar plotësisht
		20	GR ALBANIA SHPK	

PJESA E KATËRT

4.1 Vlerësimi i akteve dhe projektakteve normative

Në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003, AK, për arsye të interesit të përgjithshëm dhe në bashkëpunim me administratën qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, vlerëson barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ, të cilat mund të vijnë për shkak të a) kufizimeve sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; b) vendosjes së të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; c) imponimit të praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Gjatë vitit 2024, AK ka realizuar:

- *Tregu i mediave audiovizive*

Gjatë muajit Janar 2024, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) solli për vlerësim pranë AK, Projekt Dokumentin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026. Pas vlerësimit, KK, me vendimin nr.1060, datë 23. 02. 2024 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Mediave Audiovizive”, vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Mediave Audiovizive që:

1. Në hartimin e metodologjisë për matjen e audiencës të operatorëve televizivë (OSHMA), të aplikojë metodat më të përshtatshme, duke reflektuar parimet bazë të konkurrencës që janë barazia, gjithpërfshirja, transparenca, mosdiskriminimi, përgjegjshmëria etj. Mbi bazën e të cilit të gjithë operatorët e tregut të shprehin opinionet dhe sugjerimet e tyre.
2. Të sjellë për vlerësim *ex ante* pranë Autoritetit të Konkurrencës, çdo projekt akt normativ që do të rrjedhë nga zbatimi i Planit Strategjik të Veprimit për periudhën 2024-2026, në lidhje me matjen e audiencës.
3. Pas formimit të Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), studimin e përbashkët të industrisë audiovizive që do të prodhojë, ta bëjë me dije në Autoritetin e Konkurrencës, dhe
4. Çdo vendimmarrje e KPI-së që mund të ketë lidhje me pjesët e tregut sipas matjes së audiencës, të dërgohet për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës, për të vlerësuar nëse çënon konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

- *Tregu i shërbimeve celulare*

Në kuadër të dokumentit të publikuar nga AKEP sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 16, datë 16.11.2023, “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”, KK, është shprehur me Vendimin nr. 1048, datë 16.01.2024 “Për dhënien

e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me Dokumentin për Këshillim Publik “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”, dhe vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:

- i. Në kushtet e ndryshimeve strukturore të ndodhura në tregun e telefonisë celulare të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu.
- ii. Për përcaktimin e tarifave të terminimit të implementojë metodologjinë e vendeve të BE duke patur si qëllim parësor çmime të orientuara drejt kostos.

Në kuadër të dokumentit të publikuar nga AKEP sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 1, datë 10.01.2024, “Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband fiks”, KK, është shprehur me Vendimin nr. 1069, datë 29.03.2024 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me Dokumentin për Këshillim Publik “Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband fiks” dhe vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:

- a) Mbatjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për ndërmarrjen One Albania në:
 - i. tregun e aksesit lokal me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse (WLA);
 - ii. tregun e aksesit qendror me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm (WCA);
 - iii. tregun e aksesit me shumicë me cilësi të lartë të ofruar në një vendndodhje fikse (WHQA).
- b) Ndërhyrjen rregullatore dhe marrjen e masave përkatëse nga ana e AKEP në tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndërrurbane, për të adresuar problematikat që shkaktohen nga mospasja e konkurrencës në këtë treg.

- *Tregu i energjisë dhe gazit*

ERE, gjatë vitit 2024, ka dërguar për vlerësim ligjor pranë AK projekt aktet normative në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si me poshtë vijon:

1. Vendim i ERE nr. 349, datë 22.11.2023 Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.07.2023, “mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike Alpex SHA”, si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO)”;
2. Vendim i ERE nr. 364, datë 15.12.2023 “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024”;

3. Vendim i ERE nr. 377, datë 26.12.2023 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë mbi përcaktimin të detyrimit për energjinë e rinovueshme”;
4. VENDIM i ERE nr. 379, datë 28.12.2023 “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënien e garancive të origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”;
5. Vendimi i ERE nr. 25, datë 22.02.2024 “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2023”;
6. Vendim i ERE nr. 43, datë 29.03.2024 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar”;
7. Vendim i ERE nr. 44, datë 29.03.2024 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës shqiptare të furnizuesve të energjisë elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 186, datë 06.06.2023”;
8. Vendim i ERE nr. 145, datë 19.07.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar”;
9. Vendim i ERE nr. 192, datë 18.09.2024 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST SHA për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025 – 2027”.

- *Spektori i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave:*

ERRU, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ka sjellë për vlerësim ligjor pranë AK projekt aktin normativ mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor, për Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA, Ujësjellës Kanalizime Fier SHA, Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA, Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA, Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA dhe Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA

KK, meVendimin nr. 1061, datë 06.03.2024 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, Kurbin, Mirditë ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë SHA seancat e zhvilluara të dëgjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

KK, me Vendimin nr. 1072, datë 19.04.2024 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Fier, Roskovec dhe Mallakastër, si edhe në ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA seancat e zhvilluara të dëgjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

KK, me Vendimin nr. 1079, datë 24.05.2024 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë, si edhe në ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA seancat e zhvilluara të dëgjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

KK, me Vendimin nr. 1094, datë 11.07.2024, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.

2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec, ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

KK, me Vendimin nr. 1129, datë 07.11.2024, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Memaliaj, Libohovë, Këlcyrë, Dropull, si edhe në ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

KK, me Vendimin nr. 1137, datë 06.12.2024, “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA”, vendosi t’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, Malësia e Madhe, Vau i Dejës, Fushë Arrëz dhe Pukë si edhe në ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

4.2 Advokacia e Konkurrencës

Gjatë vitit 2024, AK në kuadër të promovimit të advokacisë dhe kulturës së konkurrencës, ka organizuar workshope dhe takime me grupet e interesit, botën akademike dhe mediat.

Në fokus të promovimit të mëtejshëm të kulturës së konkurrencës me botën akademike, në datën *15 maj 2024*, në ambientet e Universitetit “Epoka”, me bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe Departamentit të Drejtësisë së Universitetit “Epoka”, u zhvillua konferenca e parë studentore me temë “Konkurrenca, tregu dhe teknologjia”. Në këtë konferencë morën pjesë Kryetari i AK, z. Denar Biba, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, Dekani i Universitetit “Epoka”, z. Lisen Bashkurti, Rektori, z. Ahmet Oztas dhe profesorë e studentë të departamentit të drejtësisë së këtij universiteti.

Në datë *17 tetor 2024*, AK organizoi, workshop-in me temë “Advokacia e Konkurrencës”, ku u ftuan dhe moren pjesë përfaqësues të ndryshëm të mediave. Aktiviteti u moderua nga Kryetari i AK, z. Denar Biba, e anëtarë të stafit të AK-së dhe kishte si synim theksimin e rolit të medias si një urë lidhëse midis AK dhe qytetarëve. Ndërveprimi i vazhdueshëm me median është thelbësor për t’i sjellë publikut një kuptim më të mirë të rolit dhe veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës në mbrojtjen e një tregu të drejtë dhe konkurrues. Gjatë prezantimeve, u trajtuan çështje të ndryshme të fushës së konkurrencës dhe rëndësia e promovimit të saj për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Përfaqësuesit e mediave patën mundësinë të mësojnë më shumë rreth proceseve të monitorimit dhe zbatimit të ligjit të konkurrencës, marreveshjeve të ndaluara dhe abuzimit me pozitën dominuese si dhe përpjekjeve të AK-së për të siguruar që tregjet të funksionojnë në mënyrë të drejtë dhe transparente. Workshop-i kontribuon ndjeshëm në ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e konkurrencës së drejte. Përmes këtij bashkëpunimi me median, Autoriteti i Konkurrencës synon të rrisë transparencën dhe të sigurojë një komunikim efektiv me qytetarët për çështje të rëndësishme që lidhen me tregjet dhe konkurrencën.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Konkurrencës, *5 dhjetor 2024* dhe në vijim të aktiviteteve që AK zhvillon për promovimin e kulturës së konkurrencës u zhvillua një workshop me studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Në këtë workshop u prezantuan tre punime të AK: Roli i Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg; Analiza e konkurrencës dhe struktura e tregjeve; Analiza ekonomike në rastet e abuzimit me pozitën dominuese. Gjatë prezantimeve, u trajtuan çështje të ndryshme të fushës së konkurrencës dhe rëndësia e promovimit të saj për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Studentët dhe pedagogët pjesëmarrës patën mundësinë të dëgjojnë më shumë rreth proceseve të monitorimit dhe zbatimit të ligjit të konkurrencës.

AK nxit organizimin dhe kthimin në traditë të aktiviteteve të tilla si një nga mënyrat më të mira për promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës, përmes intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike.

PJESA E PESTË

INTEGRIMI EVROPIAN dhe BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

5.1 Kontributi në kuadrin e Integrimit Evropian

Procesi i integrimit evropian përbën një nga prioritetet e veprimtarisë së AK. Si një institucion lider dhe koordinator për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, AK jep

kontributin e tij në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), raporton në mënyrë periodike pranë Kryenegociatorit, për “Tregun e brendshëm dhe konkurrencën”, si dhe jep kontributin e tij për Progres Raportin.

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 - 2026, Autoriteti i Konkurrencës ka përbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, aktet nënligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

- KK, me Vendimin nr. 1093, datë 11.07.2024, ka miratuar Udhëzimin "Mbi zbatimin e Ligjit nr. 9121/2003 "Mbi mbrojtjen e konkurrencës" për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së të vetëpunësuarve", në përputhje me 'Njoftimin e Komisionit Evropian "Udhëzime mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës së Bashkimit Evropian për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar të pavarur" (2022/C 374/02)'.
- KK, me Vendimin nr. 1108, datë 16.09.2024, ka miratuar Udhëzimin "Për referimin e çështjeve në lidhje me përqendrimet", në përputhje me 'Njoftimin e Komisionit Evropian "Për Referimin e Çështjeve në lidhje me Përqendrimet (2005/C 56/02)'.
- Në kuadër të Platformës së Partneritetit është organizuar një takim në mars 2024, me fokus në prezantimin e nismave të reja ligjore dhe akteve të miratuara nga Komisioni i Konkurrencës në kuadër të PKIE 2023-2025.
- *Nënkomiteti "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrueshmëria përfshirë Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit"*

Takimi i 15-të i Nën Komitetit të Stabilizim-Asocimit Bashkimi Evropian – Shqipëri "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrueshmëria përfshirë Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit", u zhvillua në 30 maj 2024 në Bruksel. AK paraqiti një raport të hollësishëm të aktivitetit të institucionit, lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit dhe nismat e parashikuara në të ardhmen, aktivitetet zbatuese dhe implementimin e ligjit si dhe lidhur me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Përfaqësuesit e BE-së vlerësuan ndërhyrjet në treg nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e KK, rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore e ato rregullatore, si dhe procesin e përafrimit dhe plotësimit të legjislacionit.

5.2 Memorandume Bashkëpunimi

AK vijon të synojë zgjerimin e bashkëpunimit me Autoritetet e Konkurrencës së vendeve të rajonit dhe më gjerë, me qëllim promovimin dhe rritjen e kulturës së konkurrencës.

Gjatë vitit 2024 ka realizuar:

- *Memorandum me Agjensinë për Mbrojtjen e Konkurrencës, Mal i Zi*

Në datën 7 tetor 2024, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës z. Denar Biba priti Kryetarin e Autoritetit të Konkurrencës të Malit të Zi z. Dragan Damjanovic. Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit midis dy institucioneve, në kuadër të rritjes së konkurrencës në treg dhe

integritet ekonomik nëpërmjet një ekonomie tregu të hapur dhe sa më konkurruese. Në këtë kontekst, u nënshkrua dhe Marrëveshja e Mirëkuptimit në Fushën e Zbatimit dhe Politikës së Konkurrencës.

Kjo marrëveshje, synon të rrisë edhe më tej shkëmbimin e informacionit dhe politikat në fushën e zbatimit të ligjit të konkurrencës, ndarjen e ekspertizës në fushën e hetimeve lidhur me shkeljen e rregullave të konkurrencës, shkëmbimin e përvojave në fushën e promovimit të konkurrencës si dhe organizimi i vizitave studimore dhe trainimeve të ekspertëve.

- *Memorandum me Zyrën Polake të Mbrojtjes së Konkurrencës dhe Konsumatorit, Poloni*

Në datën 9 dhjetor 2024, në kuadër të vizitës zyrtare në Varshavë, Poloni, e cila u zhvillua në bashkëpunim me Zyrën Polake të Mbrojtjes së Konkurrencës dhe Konsumatorit (UOKiK) dhe me mbështetjen e instrumentit TAIEX të Bashkimit Europian, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit mes Autoriteteve të Konkurrencës të Shqipërisë dhe Polonisë. Ky memorandum kishte si qëllim lehtësimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e zbatimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës.

5.3 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

5.3.1 Aktivitete

Gjatë vitit 2024, në kuadër të forcimit të kapaciteteve njerëzore të AK, me asistencën e TAIEX, BE (Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Komisionit Evropian), në bashkëpunim me Zyrën Polake të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, u zhvilluan 2 *workshope* dhe 1 *vizitë studimore*.

Në datat 7 - 8 maj 2024, u zhvillua workshop-i mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës dhe advokacisë. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm tre përfaqësues të Zyrës Polake të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Në datat 4 - 6 nëntor 2024, në ambientet e Autoritetit të Konkurrencës, u zhvillua misioni i rradhës së TaieX mbi inspektimet dhe marrëveshjet në oferta në prokurimet publike.

Këto workshop-e kishin si qëllim përvetësimin e përvojës polake dhe shkëmbimin e eksperiencave në procedurat antitrust dhe sfidat e reja për autoritetin e konkurrencës në përballjet me tregjet ekzistuese, ato sensitive dhe tregjet e reja. Në këtë workshop-e mori pjesë i gjithë stafi i AK, me synim zgjerimin e njohurive dhe përditësimin profesional mbi legjislacionin dhe metodologjinë që duhet ndjekur gjatë trajtimit të rasteve të abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe marrëveshjeve në prokurimet publike. Gjithashtu, stafi i AK u njoh më në thellësi me përvojën polake mbi Programin e Lehtësimit nga Gjobat, implementimit të Direktivës ECN+ në Poloni, tregjet digjitale dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të konkurrencës dhe rregullatorëve sektorialë.

Në datat 9 - 11 dhjetor 2024, një delegacion nga AK zhvilloi një vizitë zyrtare në Varshavë, Poloni. Ky aktivitet kishte si qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ofrimin e ekspertizës në fushën e mbrojtjes së konkurrencës. Vizita synoi shkëmbimin e përvojave dhe

praktikave më të mira në prezantimet e përfaqësuesve të lartë të UOKiK në: efikasitetin institucional, vlerësimet ligjore dhe proceset legjislativë, praktikat e padrejta tregtare në sektorin bujqësor, kontrolli i përqendrimeve dhe transparenca përmes komunikimit me publikun. Kjo vizitë ndër të tjera synon angazhimin drejt përmirësimit dhe përditësimit të praktikave të punës në fushën e konkurrencës dhe politikave që zbatohen në funksion të saj dhe intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Polonisë në fushën e konkurrencës.

Gjithashtu, gjatë veprimtarisë së vitit 2024, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë. Stafit i AK është trajnuar në kuadër të bashkëpunimit me organizatat, si më poshtë vijon:

- Në kuadër të bashkëpunimit me OECD - GVH/RCC janë realizuar 4 *seminare* si më poshtë:
 1. Në datat 5 - 8 shkurt 2024 u zhvillua nga RCC seminari prezantues për stafin e ri në fushën e konkurrencës, në Bilbao, Spanjë, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
 2. Në datat 15 - 17 prill 2024 u zhvillua nga RCC seminari me temë “Energjia dhe Politika e Konkurrencës”, në Kishinau, Moldavi, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
 3. Në datat 14 - 16 maj 2024 u zhvillua nga RCC seminari për zbulimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike, në Budapest, Hungari, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
 4. Në datat 24 - 26 shtator 2024 u zhvillua nga RCC në bashkëpunim me Agjencinë për Mbrojtjen e Konkurrencës të Malit të Zi, seminar me temë “Mjete për rritjen e efikasitetit në zbatimin e ligjit antitrust”, në Podgoricë, Mali i Zi, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
- Në kuadër të bashkëpunimit me OECD, KE, ABA, Forumi Capitol, ERA, UNCTAD, Komuniteti i Energjisë dhe Autoritete homologe, janë organizuar aktivitete si më poshtë:

➤ *5 Konferenca:*

1. Në datën 31 janar 2024 u zhvillua nga Forumi Capitol, Konferenca me temë “Antitrust, rregullore dhe rendi i ardhshëm në botë”, në Bruksel, Belgjikë, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
2. Në datat 28 shkurt - 1 mars 2024 u zhvillua nga Bundeskartellamt (Autoriteti Gjerman i Konkurrencës), Konferenca e 22-të ndërkombëtare për konkurrencën, në Berlin, Gjermani ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
3. Në datën 22 tetor 2024 u zhvillua nga Autoriteti Hungarez i Konkurrencës, Konferenca “Dita e 50-të Evropiane e Konkurrencës”, në Budapest, Hungari, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
4. Në datat 27 - 28 nëntor 2024 u zhvillua nga Komuniteti i Energjisë “Konferenca e dytë të Komunitetit të Energjisë për avancimin e investimeve të rinovueshme”, në Lubjanë, Slloveni, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
5. Në datat 20 - 22 nëntor 2024 u zhvillua nga Agjencia Gjeorgjiane e Konkurrencës dhe Konsumatorit Konferenca e III Ndërkombëtare “Konkurrenca dhe Mbrojtja e Konsumatorit”, në Tbilisi, Gjeorgji, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.

➤ *4 Takime:*

1. Në datat 10 - 12 prill 2024 u zhvillua nga ABA (American Bar Association) Takimi Pranveror i ABA mbi Ligjin Antitrust, në Washington, DC, SHBA, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
2. Në datën 30 maj 2024 u zhvillua nga Komisioni Europian Takimi i 15-të i Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit, në Bruksel, Belgjikë, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
3. Në datat 3 - 5 korrik 2024 u zhvillua nga UNCTAD Takimi për Sesionin e 22-të të Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve të UNCTAD (IGE), në Gjenevë, Zvicër, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.
4. Në datat 29 shtator - 1 tetor 2024 u zhvillua nga Autoriteti Turk i Konkurrencës takimi për Platformën Ballkanike për Konkurrencën, në Stamboll, Turqi, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.

➤ *2 Seminare:*

1. Në datën 5 mars 2024 u zhvillua nga OECD, seminari me temë “Zhvillimet e fundit në luftimin e marrëveshjeve në oferta në procedurat e prokurimeve publike”, në Paris, Francë, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.
2. Në datën 8 nëntor 2024 u zhvillua nga OECD seminari me temë “Ndërveprimi ndërmjet kornizave rregullatore dixhitale – Sfidat dhe mundësitë e bashkëpunimit strukturor”, në Paris, Francë, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.

➤ *1 Forum:*

1. Në datat 2 - 3 dhjetor 2024 u zhvillua nga OECD Forumi Global i Konkurrencës, në Paris, Francë, ku kanë marrë pjesë 3 punonjës.

➤ *1 Kurs Veror:*

1. Në datat 1 - 5 korrik 2024 u zhvillua nga ERA (Akademia e të Drejtës Evropiane) Kursi veror “Mbi të drejtën evropiane të ligjit antitrust”, në Trier, Gjermani, ku ka marrë pjesë 1 punonjës.

➤ *1 Trajnim:*


1. Në datat 7 - 8 tetor 2024 u zhvillua nga Komisioni Europian Trainim me temë “Konkurrenca dhe Ndhurma Shtetërore”, në Bruksel, Belgjikë, ku kanë marrë pjesë 2 punonjës.

PJESA E GJASHTË

ORGANIZIMI I AUTORITETIT

6.1 Organizimi i Autoritetit të Konkurrencës

Për vitin 2024, Autoriteti i Konkurrencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, ka pasur si objektiv strategjik të tij, për t'u afruar sa më shumë me modelin institucional të institucioneve homologe të vendeve të BE. Autoriteti i Konkurrencës është i organizuar nga një numër prej 49 punonjësish, sipas strukturës së miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 42/2023 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Konkurrencës”.




6.2 Realizimi i buxhetit për vitin 2024

Gjatë vitit 2024, përdorimi i buxhetit të miratuar për AK ka qenë konform kërkesave të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe është përdorur me efikasitet për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të punonjësve, për realizimin e detyrave të ngarkuara për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Kodi	Emërtimi	Plani (me ndryshime)	Fakti	%
600	Paga, shpërblime etj	87,400,000 Lekë	80,826,952 Lekë	92%
601	Kontribute për sigurime shoqërore	13,740,000 Lekë	12,869,238 Lekë	94%
602	Materiale dhe shërbime	9,820,000 Lekë	7,034,756 Lekë	72%
606	Ndihma ekonomike	1,142,528 Lekë	1,065,704 Lekë	93%
231	Investime	1'000'000 Lekë	921,360 Lekë	92%
Totali		113,102,528 Lekë	102,718,010 Lekë	91%

REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2024



6.3 Të ardhurat e realizuara

Gjatë këtij viti, në buxhetin e shtetit është derdhur si e ardhur nga perqendrimet (njoftime dhe autorizime perqendrimi) deri më 31 dhjetor 2024 shuma 27,865,000 lekë. Të ardhurat e arkëtuara në buxhetin e shtetit nga vjelja e gjobave deri më 31 dhjetor 2024 janë në shumën 124,988,723 lekë.


Të ardhura të arkëtuara	Viti
	2024
Nga procedurat e perqendrimeve	27,865,000.00
Nga gjobat	124,988,723.00
Të tjera (akt detyrim kthimi nga KLSH)	20,000.00
Total	152,873,723.00

6.4 Trajnimet dhe rekrutimet

Gjatë vitit 2024, në kuadër të plotësimit të nevojave të drejtorive teknike janë realizuar 3 procedura konkurimi me ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil. Të gjitha procedurat janë realizuar konform kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 19 aktivitete jashtë vendit dhe 17 trajnime brenda vendit, ndër të tjera dhe webinarë informuese nga ASPA. Është trajnuar pothuaj i gjithë stafi teknik i institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezulton të jenë trajnuar më shumë se një herë.

Aktivitete dhe Trajnime 2024




Të gjitha trajnimet jashtë vendit janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të AK me RCC, OECD, KE, ABA, UNCTAD, TAIEX, Komuniteti i Energjisë dhe ato brenda vendit nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA).

Aktivitete jashtë vendit




■ Legjislacion ■ Ekonomi ■ Prokurime Publike ■ Energji

46 ditë Aktivitete jashtë vendit



■ Legjislacion ■ Ekonomi
■ Prokurime Publike ■ Energji

Punonjës të trajnuar jashtë vendit



■ Legjislacion ■ Ekonomi ■ Prokurime Publike ■ Energji

PJESA E SHTATË

PRIORITETET E AK PËR VITIN 2025

7.1 Prioritetet e AK për vitin 2025

Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë monitorimet, hetimet dhe analizat në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, si:

- Tregu i telefonisë celulare
- Tregu i hidrokarbureve
- Tregu i prokurimeve
- Tregu bankar
- Tregu sigurimeve
- Tregu farmaceutik
- Tregu i grumbullimit të produkteve bujqësore
- Tregu i produkteve të shportës ushqimore
- Tregu i punës

Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë rast pas rasti sjelljen e ndërmarrjeve të cilat gëzojnë pozitë dominuese nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare.

7.2 Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE

Disa nga prioritetet e PKIE 2025 – 2027, për vitin 2025, në fushën e konkurrencës janë hartimi i disa rregulloreve dhe udhëzimeve për të plotësuar kuadrin ligjor dytësor dhe konkretisht:

- Në katërmujorin e dytë të vitit 2025 është parashikuar miratimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës i aktit ‘Rregullore “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”’, në përputhje me aktin e acquis “Rregullorja e Komisionit (BE) 2023/1066 e datës 1 qershor 2023 për zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian për disa kategori të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit (C/2023/3443)”.
- Në katërmujorin e tretë të vitit 2025 është parashikuar miratimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës i aktit ‘Udhëzim "Mbi marrëveshjet vertikale"', në përputhje me aktin e acquis ‘Njoftim i Komisionit “Udhëzime mbi kufizimet vertikale” (2022/C 248/01)’.
- Në katërmujorin e tretë të vitit 2025 është parashikuar miratimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës i aktit ‘Rregullore "Per perjashtimin ne bllok te kategorive te marrveshjeve vertikale dhe praktikave te bashkerenduara"', në përputhje me aktin e acquis “Rregullorja e Komisionit (BE) 2022/720 e datës 10 maj 2022 për zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian ndaj kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe

praktikave të bashkërenduara (C/2022/3015)”.

- Në katërmujorin e tretë të vitit 2025 është parashikuar miratimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës i aktit ‘Rregullore “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të specializimit”’, në përputhje me aktin e acquis “Rregullorja e Komisionit (BE) 2023/1067 e datës 1 qershor 2023 për zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për disa kategori të marrëveshjeve të specializimit (C/2023/3448)”.

Forcimin e kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimit të stafit të ri dhe ekzistues me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, mbrojtjes së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Adresimin në mënyrë të përshtatshme dhe domethënëse të çështjeve sensitive (trajtimi i ankesave), si dhe bashkëpunimin me institucionet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e RSH për të siguruar një konkurrencë efektive në treg.

Angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe ente rregullatorë, duke nënshkruar me to edhe memorandume mirëkuptimi (MOU).

Autoriteti i Konkurrencës si përfitues i projektit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për asistencë teknike dhe suport për zbatimin e strategjisë së advokacisë do do mbështesë në realizimin e trajnimit të gjyqtareve, trajnimin e stafit, organizimin e forumit të përbashkët me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe organizimit të seminareve me komunitetin e biznesit për advokacinë e konkurrencës.